



# **AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Vlerësim institucional i institucioneve të arsimit të  
lartë në Shqipëri

**Raporti i akreditimit periodik institucional  
për Kolegjin Universitar LOGOS**

Qershor 2021

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:**

1. Kevin Kendall                      Kryetar
2. Alketa Grepcka                      Anëtare

## Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	4
Konteksti i vlerësimit .....	5
Përmbledhje e raportit.....	7
Përmbledhje e gjetjeve.....	9
Praktika e mirë .....	9
Dobësitë .....	9
Rekomandime .....	9
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	9
Përmbledhje e gjykimeve për çdo fushë vlerësimi.....	10
Përmbledhje e gjykimit.....	11
Raport i detajuar .....	12
Fusha e vlerësimit 1: organizimi dhe menaxhimi .....	12
Gjetjet .....	15
Praktika e mirë .....	15
Dobësitë .....	15
Rekomandime .....	16
Pohim i veprimeve të ndërmarra.....	16
Gjykim .....	16
Fusha e vlerësimit 2: Burimet.....	17
Gjetjet .....	20
Praktika e mirë .....	20
Dobësitë .....	20
Rekomandime .....	20
Pohim i veprimeve të ndërmarra.....	20
Gjykim .....	21
Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula.....	21
Gjetje .....	26
Praktika e mirë .....	26
Dobësitë .....	26
Rekomandime .....	27
Pohim i veprimeve të ndërmarra.....	27
Gjykim .....	27
Fusha e vlerësimit 4: mësimdhënia, të nxënit, vlerësimi dhe kërkimi.....	28

## Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i vlerësimit institucional është të kontrollojë dhe vlerësojë se në çfarë mase IAL-të përmbushin standardet shtetërore të cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi institucional është një proces kontrolli dhe vlerësim nga ekspertë të jashtëm, ku secili grup vlerësimi përbëhet nga ekspertë ndërkombëtarë dhe shqiptarë, të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet e përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, në bazë të shkallës që IAL-ja përmbush standardet, por edhe për informimin e IAL-ve, Qeverisë Shqiptare, publikut dhe studentëve mbi shkallën që IAL-ja përmbush standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojë çështjet me përparësi për tu përmirësuar (procesi përmes të cilit ofruesit e arsimit të lartë përmirësojnë sistematikisht cilësinë e shërbimit dhe mënyrat si ata mbështetin studentët për të nxënë).

Standardet shtetërore shqiptare të cilësisë janë grupuar në pesë fusha vlerësimi: organizimi dhe menaxhimi; burimet; kurrikulat; mësimdhënia, të nxënit, vlerësimi dhe kërkimi; si dhe studentët e mbështetja e tyre. Ky raport paraqet karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e masave në veprim dhe dobësitë e identifikuara për çdo fushë vlerësimi, së bashku me një gjykim mbi shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja. Vlerësuesit mund të japin këto gjykime: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur në mënyrë domethënëse; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në përfundim, vlerësuesit dalim me një rekomandim, në formën e një gjykimi të përmbledhur, drejtuar Këshillit të Akreditimit të ASCAL-it. Ky gjykim i përmbledhur mund të jetë një nga katër shkallët e mëposhtme:

- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur.**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur në mënyrë domethënëse**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë nuk janë përmbushur.**

## **Konteksti i vlerësimit**

Kolegji Universitar Logos (KU Logos) u themelua në vitin 2008 dhe është një institucion arsimor privat me qendër në Tiranë, Shqipëri. Ai mbështetet financiarisht nga Fondacioni Logos, i themeluar nga Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë që është edhe president i Fondacionit Logos.

Në vitin 2000, Instituti i Formimit Profesional “Fryma e Dashurisë”, që ishte edhe pararendës i Logos-it, mori licencë për të mbështetur nevojën për aftësi profesionale në Shqipëri. Gjatë kësaj kohe, instituti ofroi programe në kontabilitet të kompjuterizuar, informatikë, menaxhim ekzekutiv dhe lëndë laboratorike mjekësore. Megjithatë, u konstatua nevoja për të ofruar programe diplomash në përputhje me “Sistemin e Bolonjës” dhe u krijua Fondacioni Logos. Fillimisht, në vitin 2008, u quajt Instituti i Trajnimit Profesional, ndërsa në vitin 2011, u lejua të ndryshonte emrin në institucion i arsimit të lartë privat (IALP) Logos. Në atë kohë, kishte dy fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara që ofronte një program të ciklit të parë për informatikë të aplikuar dhe Fakulteti i Ekonomisë që ofronte një program të ciklit të parë në menaxhim turizmi.

Më pas, IAL Logos zgjeroi ofertën e tij të programeve të arsimit të lartë në shkencat teknike mjekësore. Në vitin 2011, ofroi një program të ciklit të parë në teknikë të lartë në laborator mjekësor dhe gjithashtu dy programe të reja të ciklit të parë në financë dhe kontabilitet dhe menaxhim biznesi. Në vijim të këtyre dy programeve, në vitin 2013, u ofruan dy programe të ciklit të dytë, përkatësisht Master profesional në teknikë të lartë në laborator mjekësor dhe kontabilitet- financë. Në vitin 2015, u akredituar programi i ciklit të dytë, Master profesional në financë-kontabilitet.

Nga viti 2017, IAL Logos ndryshoi statusin e tij në Kolegjin Universitar Logos (KU Logos) dhe tashmë ka tre fakultete: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Aktualisht ka 298 studentë.

Fakulteti i Ekonomisë ka tre departamente, përkatësisht Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Agrobiznesit. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara gjithashtu ka tre departamente, përkatësisht Departamenti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Informatikës dhe Statistikave të Aplikuara dhe Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor ka tre departamente, përkatësisht Departamenti i Gjuhës dhe Qytetërimit Grek, Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës dhe Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë.

Kisha është pronare e pronën ku vepron KU Logos. Ai ka dy kampuse; njëri është ngritur në qendër të Tiranës në një godinë shumëkatëshe, ndërsa tjetri gjendet në një zonë prej 8 hektarë, jashtë Tiranës, në rrugën për në Durrës (Shën Vlash). Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara janë të vendosura në Tiranë, ndërsa Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor është i vendosur kampusin e ri drejt Durrësit.

Përveç fakulteteve dhe departamenteve, njësitë drejtuese dhe administrative janë rektorati, bordi i administrimit, senati akademik, njësia e sigurimit të cilësisë së brendshme, zyra e financës dhe shërbimeve, zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare, kancelaria, zyra e protokoll-arkivit, zyra e pranimeve dhe këshillimit për karrierës, si dhe biblioteka.

KU Logos ofron tashmë tetë programe të ciklit të parë dhe dy të ciklit të dytë; këto të fundit janë programe Master profesional. Programet e ciklit të parë janë programe tre vjeçare Bachelor në informatikë të aplikuar, teknikë në laborator mjekësor, menaxhim turizmi, kontabilitet- financë dhe menaxhim biznesi, gjuhë dhe qytetërim grek dhe mësuesi për ciklin parashkollor. Programet e ciklit të dytë janë financë dhe kontabilitet dhe teknikë e lartë në laborator mjekësor. Ofrohet gjithashtu edhe një diplomë profesionale për agrobiznes.

Në vitin akademik 2017-2018, kishte 36 studentë të regjistruar në programet e ciklit të parë dhe 42 studentë në programet e ciklit të dytë; në vitin akademik 2018-2019, kishte 101 studentë të regjistruar në programet e ciklit të parë dhe 63 studentë në programin e ciklit të dytë; ndërsa në vitin akademik 2019-2020, kishte 86 studentë të regjistruar në programet e ciklit të parë dhe 49 studentë në programet e ciklit të dytë. Nga viti 2017-2020, ka një luhajtje të numrit të studentëve të regjistruar. Ka një rritje të konsiderueshme të numrit të studentëve të regjistruar në të dy ciklet e programeve nga 2017-2018 në 2018-2019 dhe një rënie të lehtë të numrit të studentëve nga 2018-2019 në 2019-2020. Për periudhën 2017-2020, ka një rritje të numrit të stafit mësimor. Në vitin akademik 2017-2018, kishte shtatë profesorë, 16 lektorë dhe 27 asistentë (4 profesorë të asociuar, 5 lektorë, 4 asistentë lektorë me kohë të pjesshme); në vitin akademik 2018-2019, kishte 24 profesorë, 31 lektorë dhe 32 asistentë lektor (14 profesorë, 20 lektorë dhe 13 asistentë lektor me kohë të pjesshme); në vitin 2019-2019, kishte gjithsej 37 profesorë, 45 lektorë dhe 39 asistentë lektorë (26 profesorë, 29 lektorë, 16 asistentë lektorë me kohë të pjesshme). Stafi mësimor është rritur gjatë tre viteve të fundit duke reduktuar ngarkesën mësimore për stafin akademik të punësuar me kohë të plotë. Për vitin akademik 2017-2019, ngarkesa mësimore e profesorëve ishte 200 orë, profesor i asociuar 220 orë, lektor dhe asistent lektor, përkatësisht 300 orë. Për vitet 2018-2019 dhe 2019-2020, ngarkesa mësimore e profesorëve ishte 140-145 orë, lektor 165 orë dhe asistent lektor 195 orë, gjë që është në përputhje me udhëzimin Nr. 29 datë 10.09.2018 të MAS-it "Për ngarkesën mësimore".

## **Përmbledhje e raportit**

Një ekip prej shtatë personash, të cilët përfaqësonin të gjitha fushat kryesore të fakultetit, administratën dhe një përfaqësues të studentëve, hartoi raportin e vetëvlerësimit për KU Logos. Gjatë hartimit të këtij raporti, grupi i vetëvlerësimit mori qasje në dokumentacion, si nga departamentet akademike ashtu edhe ato administrative. Puna e tij u bazua në parimet e objektivitetit, transparencës, paanësisë dhe respektimit të autonomisë akademike.

Dokumenti i vetëvlerësimit trajton secilën nga pesë fushat e vlerësimit, sipas renditjes, dhe i referohet një liste tejet gjithëpërfshirëse me evidenca. Raporti nis me përshkrimi e sfondin historik të KU Logos dhe, më pas, diskuton veprimet e ndërmarra për të trajtuar rekomandimet e lëna nga vlerësimi i mëparshëm i vitit 2017. Në gjykimin e ekipit të vetëvlerësimit, janë përmbushur plotësisht kërkesat për secilën prej fushave të vlerësimit: organizimi dhe menaxhimi, burimet, kurrikula, mësimdhënia, të nxënit, vlerësimi dhe kërkimi, si dhe studentët dhe mbështetja e tyre.

U zhvilluan vizita virtuale dhe në vend gjatë dy ditëve, më 19-20 prill 2021. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga një vlerësues nga Mbretëria e Bashkuar me përvojë në arsimin e lartë dhe një anëtar nga një institucion shqiptar me përvojë në arsimin e lartë. Nga ana e ASCAL-it, drejtuesi i vlerësimit mbështeti grupin e vlerësimit si dhe i vendosi në dispozicion një sekretar për mbajtjen e procesverbalit. Grupi i vlerësimit mori në shqyrtim RVV-në dhe dokumentacionin mbështetës të mbledhur tetë javë përpara vizitës vlerësuese. Këto dokumente përshkruajnë strukturat, politikat dhe procedurat mbi të cilat mbështetet aktiviteti akademik i Kolegjit dhe që bënë të mundur që grupi i vlerësimit t'i shqyrtojë duke i krahasuar me standardet shtetërore shqiptare të cilësisë. Evidencat përfshijnë rregullore dhe statute që dëshmojnë bazën ligjore të qeverisjes së KU Logos, projekt kontratat e punës së stafit dhe informacion në lidhje me programet e ofruara. RVV-ja referonte edhe faqen në internet dhe grupi i vlerësimit kishte qasje në të. Grupi i vlerësimit konstatoi se provat, si në gjuhën angleze ashtu edhe në shqip, ishin të përshtatshme për të dhënë një gjykim dhe nuk kërkoi informacion të mëtejshëm për të shqyrtuar provat për mënyrën se si KU Logos trajton standardet.

Gjatë vizitës vlerësuese, grupi i vlerësimit zhvilloi takime me rektorin, drejtues të lartë, dekanë dhe drejtues të departamenteve, studentë të ciklit të parë dhe të dytë, personel mësimdhënës, personel administrativ dhe mbështetës, njësinë e sigurimit të cilësisë, ekipin e vetëvlerësimit, si dhe partnerë të jashtëm dhe ish-studentë. Këto takime bënë që grupi i vlerësimit të qartësojë organizimin, politikat, procedurat, përgjegjësitë dhe këndvështrimet e universitetit. Gjatë të gjitha takimeve, u mbajt procesverbal. Grupi i vlerësimit bëri një turne në ambientet e kolegjit në Tiranë për të parë sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët, zyrat dhe bibliotekën.

Për fushën e vlerësimit 1, organizimi dhe menaxhimi, grupi i vlerësimit nuk identifikoi veçori të praktikës së mirë, por ra dakord me grupin e vetëvlerësimit se rekomandimet në raportin e mëparshëm ishin trajtuar dhe dobësitë ishin korrigjuar. KU Logos ka krijuar fonde për mbështetjen e stafit dhe studentëve për të përfutur nga mundësitë e

lëvizshmërisë që mund të ofrojnë marrëveshjet e bashkëpunimit dhe aktivitetet e konferencës, dhe grupi i vlerësimit pohon përpjekjet që po bëhen për t'u angazhuar me mundësitë e ofruara nga skema Erasmus për lëvizshmërinë e studentëve. Por zbatimi i këtij projekti u penguar nga pandemia Covid-19. Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në fushën e vlerësimit 1 dhe arriti në përfundimin se autonomia, organizimi dhe partneritetet janë në përputhje me standardin dhe kjo fushë është përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 2, burimet, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi veçori të praktikës së mirë ose dobësi. Megjithatë, pohon përpjekjet e bëra për zhvillimin e burimeve online për të mundësuar vazhdimin e mësimin gjatë pandemisë Covid-19. Grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në përfundimin se menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi financiar, sistemi i menaxhimit të informacionit dhe menaxhimi i veprimtarisë së institucionit janë në përputhje me këtë standard dhe kjo fushë është përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 3, kurrikulat, grupi i vlerësimit nuk identifikoi veçori të praktikës së mirë ose dobësi. Megjithatë afirmon hapjen e programeve të reja të Masterit shkencor me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së procesit arsimor. Grupi i vlerësimit arriti gjithashtu në përfundimin se programet e ofruara nga KU Logos janë në përputhje me misionin dhe kapacitetet e tij, strategjinë e zhvillimit dhe prirjet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Programet hartohen në mënyrë të përshtatshme sipas lëndës dhe nivelit, duke i dhënë studentëve mundësi për lëvizshmëri dhe duke i përgatitur ata për punësim. Prandaj, grupi i vlerësimit doli në përfundimin se kjo fushë është përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 4, mësimdhënia, të nxëniet, vlerësimi dhe kërkimi, grupi i vlerësimit nuk identifikoi veçori të praktikës së mirë ose dobësi. Megjithatë afirmon proceset që po zbatohen për përmirësimin e përmbajtjes së programeve Bachelor dhe Master profesional. Për sa i takon tre dobësitë të identifikuara në vlerësimin e mëparshëm, grupi i vlerësimit gjykoj se dobësia në lidhje me ofertën e kufizuar të librave bazë në gjuhën shqipe, qasjen e kufizuar në burime elektronike të bibliotekës dhe përdorimin e kufizuar të bibliotekës nga studentët ishte trajtuar. Është trajtuar gjithashtu rekomandimi i vlerësimit të mëparshëm në lidhje me mungesën e një procesi formal për sigurimin dhe monitorimin e përmirësimit të cilësisë bazuar në të dhënat e anketës së studentëve dhe të dhënat e punësimit të të diplomuarve dhe mungesën e një procesi për punëdhënësit dhe ish-studentët për të ndihmuar në zhvillimin e programit. Megjithatë, procedura e kryerjes së provimeve në platformë apo online për vitin akademik 2020-2021 nuk parashikon ruajtjen e qartë të anonimatit në këtë drejtim, por pranohet se pandemia Covid-19 mund të ketë qenë një faktor që ka shkaktuar vështirësi në këtë drejtim. Prandaj, grupi i vlerësimit doli në përfundimin se kjo fushë është përmbushur plotësisht.

Për fushën e vlerësimit 5, studentët dhe mbështetja e tyre, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë praktikë të mirë, por identifikoi dy dobësi. Ato lidhen me numrin e ulët të studentëve të regjistruar në disa programe Bachelor dhe mungesën e raporteve vjetore të përgatitura nga zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit për karrierë. Grupi i vlerësimit doli në përfundimin se dobësia në lidhje me mungesën e mbështetjes financiare për aktivitetet e këshillit të studentëve, e identifikuar në vlerësimin e mëparshëm, ishte



trajtuar dhe ka vijuar puna për zhvillimin e hapësirës në katin e dhjetë që do të përdoret për aktivitete sociale dhe kulturore në dobi të studentëve. Në mënyrë të përmbledhur, studentët mbështeten mirë nga KU Logos përgjatë studimeve dhe punësimit, por për shkak të dy dobësive të identifikuar, grupi i vlerësimit doli në përfundimin se ky standard është përmbushur në mënyrë thelbësore.

## **Përmbledhje e gjetjeve**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar të praktikës së mirë.

### **Dobësitë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Numri i ulët i studentëve të regjistruar për herë të parë në disa programe Bachelor (*paragrafi 5.6, 5.10) Kapitulli I, Standardi III.1, Kapitulli III, Standardi III.2*].
- Mungesa e raporteve vjetore të përgatitura nga zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit për karrierë (*paragrafi 5.9) Kapitulli I, Standardi III.2*].

### **Rekomandime**

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Të promovohet përdorimi i instrumenteve të marketingut, kërkimit të tregut dhe informacionit publik për të arritur dhe ruajtur numrin e studentëve të regjistruar për secilin program studimi, siç deklarohet nga Institucioni gjatë fazës së licencimit të programit të studimit [*paragrafi 5.6, 5.10; Kapitulli I Standardi III.1, Kapitulli III, Standardi III.2*].
- Të forcohet puna e zyrës së çështjeve studentore dhe këshillimit për karrierë në drejtim të informimit të publikut, gjurmimit të punësimit dhe karrierës së studentëve, mbledhjes, përpunimit të të dhënave dhe përgatitjes së analizave statistikore për progresin e studentëve dhe problemet e tyre të pasqyruara gjatë vitit akademik [*paragrafi 5.9, Kapitulli I, Standardi III.2*].

### **Pohimi i veprimeve të ndërmarra.**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- përpjekjet që po bëhen për të përfituar nga mundësitë që ofron skema Erasmus për lëvizshmërinë e studentëve (*paragrafi 1.4) [Kapitulli III, Standardi I.4]*].

- përpjekjet e bëra për zhvillimin e burimeve online për të mundësuar vazhdimin e mësimin gjatë pandemisë Covid-19 (*paragrafi 2.9*) [*Kapitulli III, Standardi VII.1, VII.2*].
- hapja e programeve të reja të Masterit shkencor me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së procesit arsimor (*paragrafi 3.11*) [*Kapitulli I, Standardi 1.7*].
- proceset që po zbatohen për përmirësimin e përmbajtjes së programeve Bachelor dhe Master profesional (*paragrafi 4.11*). [*Kapitulli I, Standardi II.3*].

### **Përmbledhje e gjykrimeve për çdo fushë vlerësimi**

1. Standardet për organizimin dhe menaxhimin janë **përbushur plotësisht**.
2. Standardet për burimet janë **përbushur plotësisht**.
3. Standardet për kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
4. Standardet për mësimdhënien, të nxënit, vlerësimin dhe kërkimin janë **përbushur plotësisht**.
5. Standardet për studentët dhe mbështetjen e tyre janë **përbushur në mënyrë domethënëse**.

## **Përmbledhje e gjykimit**

Grupi i vlerësimit i rekomandon Këshillit të Akreditimit që KU Logos i **përbush plotësisht** standardet shtetërore të cilësisë.

## Raport i detajuar

### Fusha e vlerësimit 1: organizimi dhe menaxhimi

1.1 KU Logos ka një statut gjithëpërfshirës (**aneksi II.1**), i cili është në përputhje me ligjin për arsimin të lartë në Shqipëri dhe në pajtim me misionin (**aneksi II.8**) dhe objektivat në planin strategjik (**aneksi II.5.1**) të institucionit. Statuti përdoret si bazë për të gjithë veprimtarinë dhe të gjitha rregulloret janë të shkruara në përputhje me të. Rregulloret e përgjithshme (**aneksi II.2**) janë në përputhje me këtë rregullore, siç sikurse edhe rregulloret për fakultetet dhe departamentet (**aneksi II.3 – II.3.8**). Rregulloret e përgjithshme (**aneksi II.2**) parashikojnë, për shembull, organizimin e KU Logos, funksionin e organeve drejtuese, përgjegjësitë e stafit akademik dhe administrativ, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve dhe procedurat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu, ka rregullore që zbatohen për secilin program studimi në ciklin e parë dhe të dytë (**aneksi II.4 – II.10**). KU Logos është i aftë të rregullojë dhe përmirësojë statutin dhe rregulloret e tij sipas nevojës, gjë që dëshmohet qartë nga miratimi i rregulloreve të reja për sigurinë në lidhje me Covid-19 (**aneksi II.18**) dhe rregulloret për mësimdhënien dhe të nxënit online (**aneksi II.19**). Prandaj, institucioni dhe strukturat e tij punojnë në përputhje me statutin e tij. **[Kapitulli III, Standardi I.1].**

1.2 Struktura organizative e KU Logos është në përputhje me statutin e tij (**aneksi II.1**) dhe është përcaktuar qartë në organikën e tij (**aneksi II.7**) dhe kuptohet nga i gjithë stafi (**M5, M6, M10, M12**). Përmes diskutimeve me stafin del qartë se KU Logos ka një strukturë efektive të menaxhimit, sipas statutit (**aneksi II.1**), ku përfshihet Bordi i Administrimit, Rektorati, Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Dekanati dhe Asambleja e Personelit Akademik. Autoritetet drejtuese janë Rektori, Administratori, Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve (**M2, M10, M12**). Sipas statutit (**aneksi I.1**), Senati Akademik është përgjegjës për miratimin e planit strategjik (**aneksi II.5.1**) dhe planet vjetore të institucionit, përfshirë miratimin e programeve të reja të studimit të propozuara nga departamentet. Rektorati është përgjegjës për hartimin e planit strategjik, duke marrë parasysh propozimet e fakulteteve, departamenteve dhe administratorit, si dhe zbatimin e vendimeve të Senatit (**M10, M12**). Gjithashtu, Rektorati paraqet buxhetin (**aneksi IX.2, IX.2.1, IX.6**) para Senatit për miratim (**M12**). Drejtuesit e departamenteve paraqesin propozime për programe të reja dhe ato diskutohen në nivel fakulteti para se të shkojnë për llogaritjen e kostos dhe miratim në Senat (**M12**). Bordi i Administrimit raporton tek Fondacioni për financat e institucionit dhe për këtë arsye miraton edhe buxhetin për burimet njerëzore dhe fizike, pas miratimit nga Senati (**M12**). Administratori harton buxhetin vjetor në bazë të propozimeve nga departamentet dhe fakultetet dhe, në fund, është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit (**aneksi II.1, M12**). Këshilli i Etikës është përgjegjës për shqyrtimin e çështjeve etike që kanë të bëjnë me mësimdhënien dhe kërkimin dhe puna e tij drejtohet si nga Statuti (**aneksi II.1**) ashtu edhe nga rregullorja e vet (**aneksi II.12**). Funksionimi i tij dëshmohet edhe nga evidencat (**aneksi IV.15**). Kancelaria mbikëqyr funksionimin e përditshëm të institucionit, ndërkohë organe të tjera të rëndësishëm janë biblioteka, zyra e burimeve njerëzore, zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare, zyra e marrëdhënieve me studentët dhe zyra e financës (**aneksi IV.2.4, M6**). Prandaj, institucioni

është i organizuar në mënyrë të tillë që siguron efikasitet në menaxhim. **[Kapitulli III, Standardi I.2].**

1.3 Nga takimet me stafin mësimdhënës (M5), stafin mbështetës (M6), dekanët dhe drejtuesit e departamenteve (M10) dhe drejtuesit e lartë (M12) doli qartë se KU Logos ka përcaktuar mirë procedurat për marrjen e vendimeve që përfshijnë angazhimin e plotë të të gjithë stafit përkatës. Mbledhjet planifikohen paraprakisht sipas Statutit (aneksi II.1) ose organizohen takime shtesë kur është e nevojshme, axhendat qarkullojnë dhe mbahen procesverbale (aneksi I.4). **[Kapitulli III, Standardi I.3].**

1.4 KU Logos vepron sipas Statutit (aneksi I.1) dhe në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Shqipëri duke respektuar lirinë akademike. Ai ka strukturat e duhura për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të aktiviteteve të tij siç tregohet përmes organikës (aneksi II.7). Monitorimi i cilësisë në KU Logos është përgjegjësi e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë së Brendshme (NJSCB) (M11) sipas Urdhrit të Senatit Akademik (aneksi VI.6). NJSCB kryen monitorimin e vazhdueshëm të funksioneve akademike dhe administrative (M11, aneksi VI.9, VI.10, VI.11). Për të pasur një këndvështrim objektiv, merren ekspertë të jashtëm dhe kjo i jep vlerë të shtuar procesit (aneksi VI.6). Ekspertët akademikë të jashtëm janë gjithashtu anëtarë të Bordit të Administrimit, gjë që sjell ekspertizë dhe objektivitet shtesë në funksionimin e Bordit (aneksi IX.1.2). KU Logos ka bërë progres domethënës në drejtim të partneriteteve me universitete lokale dhe ndërkombëtare (aneksi VIII.2, VIII.3) dhe mban korrespondencë në mënyrë efektive me Universitetin Evropian të Romës (aneksi VIII.6.1), Universitetin Egjeu (aneksi VIII.6.2) dhe Universitetin e Janinës (aneksi VIII.6.3). KU Logos ka një zyrë të marrëdhënieve ndërkombëtare, siç përcaktohet në Statut (aneksi I.1), e cila koordinon projektet ndërkombëtare, të tilla si Erasmus+. Paçka se udhëtimet janë ndaluar nga Covid-19, ajo ka qenë në gjendje të zhvillojë më tej marrëdhëniet kur kushtet e lejonin (aneksi VIII.3). Prandaj, grupi i vlerësimit pohon **përpjekjet që po bëhen për t'u angazhuar me mundësitë që ofron skema Erasmus për lëvizshmërinë e studentëve. [Kapitulli III, Standardi I.4].**

1.5 Plani strategjik i zhvillimit (aneksi II.5.1) i KU Logos është në përputhje me misionin dhe qëllimin (aneksi II.8) e institucionit dhe ka gjashtë prioritetet strategjike: zhvillimin institucional, përmbushjen e standardeve të ekselencës akademike, kërkimin, zhvillimin e partneriteteve, ndërkombëtarizimin dhe sigurimin e cilësisë. Plani është diskutuar mes stafit akademik, studentëve dhe në Bordin e Administrimit përpara se të miratohej nga Senati Akademik, në përputhje me statutin (aneksi I.1) dhe Rregulloret (aneksi II.2). Strategjia përcakton objektiva dhe mjete të përshtatshme për të arritur rezultatet e pritshme. Pjesë integrale e strategjisë është edhe zhvillimi i infrastrukturës për të mbështetur zhvillimin e programeve të reja të studimit. Ato janë propozuar në bazë të analizës së tregut të punës (aneksi III.5). Një shembull i tillë është plani për programin Bachelor dhe Master profesional në teknikat e avancuara në laborator mjekësor (aneksi II.5.3). **[Kapitulli III, Standardi I.5].**

1.6 KU Logos harton një raport vjetor (aneksi II.26.1 – 6), në përputhje me statutin e tij (aneksi I.1). (Ky raport pasqyron aktivitetet e brendshme dhe të jashtme të institucionit dhe ndihmon në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Ai publikohet çdo vit akademik dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raporti mbulon, për shembull, të dhëna në lidhje me veprimtarinë akademike, shkencore dhe administrative, informacion mbi stafin akademik, mësimdhënien dhe të nxënit, performancën e studentëve

dhe pjesëmarrjen në aktivitete dhe konferenca shkencore. Krahason performancën me vitet paraardhëse dhe i jep mundësi Rektoratit, Senatit dhe Bordit të Administrimit të marrin vendime të informuara strategjike dhe operacionale **(M12, aneksi II.26.1 – 6)**. *[Kapitulli III, Standardi I.6].*

1.7 KU Logos ka strukturat e duhura për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij, siç përshkruhet në statut **(aneksi I1.1)** dhe dëshkohet nga stafi **(M2, M5, M6, M10, M12)**. Ka tre fakultete dhe secili prej tyre ka tre departamente. KU Logos ka lidhur një marrëveshje **(aneksi I.3)** me Ministrinë për të zvogëluar numrin e anëtarëve të fakultetit nga 7 në 5 për shkak të numrit të ulët të studentëve **(aneksi VIII.13.2)** përgjatë tre viteve rresht **(aneksi IV.2.4)**. Fryma e autonomisë është mishëruar në statut **(aneksi II.1)** dhe gjithashtu pasqyrohet në rregulloret e bazuara në të, për shembull, rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor **(aneksi II.3.1)** dhe riemërtimin e një departamenti **(aneksi I.11)**, gjë që u miratua nga Bordi i Administrimit dhe Senati. Liria akademike në mësimdhënie dhe kërkim është mishëruar po ashtu në statut **(aneksi II.1)**. Shembuj të tillë janë diskutimet mes një lektori dhe shefit të departamentit për një syllabus kursi **(aneksi II.8)** dhe organizimin e një seminari **(aneksi V.5.3.2)**. KU Logos ofron programe studimi për të përmbushur misionin e tij, të cilat përmbushin kërkesën e tregut dhe janë në përputhje me planin strategjik të zhvillimit **(aneksi II.5.1)** dhe prioritetet kombëtare. Këtu përfshihen programet Bachelor në teknologjinë e laboratorëve mjekësorë, informatikën e aplikuar dhe menaxhimin e turizmit. Programet e Masterit profesional synojnë gjithashtu të përmbushin kërkesën e tregut **(aneksi III.0)**. Strukturat mbështetëse përfshijnë kancelarinë, bibliotekën, zyrën e burimeve njerëzore, protokollin dhe arkivin, zyrën e pranimeve dhe këshillimit për karrierë, zyrën e financës dhe shërbimet logjistike **(aneksi II.7)**. Këto struktura paraqiten gjithashtu në faqen e internetit të KU Logos ([www.kulogos.edu.al](http://www.kulogos.edu.al)), së bashku me shumë detaje të tjera rreth institucionit, programeve të ofruara dhe organizimin e tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se KU Logos ka strukturat e duhura për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij. *[Kapitulli III, Standardi II.1].*

1.8 KU Logos ka tetë organe vendimmarrëse, përkatësisht Senatin, Bordin e Administrimit, Rektoratin, Këshillin e Etikës, dy komisione të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë dhe marrëdhëniet me studentët, Asamblenë e Personelit Akademik **(aneksi II.1, II.2)**, dekanatin dhe këshillin e studentëve. Secili prej tyre ka përgjegjësi të veçanta. Për shembull, Senati është përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe miratimin e buxhetit siç përcaktohet në rregulloren e Senatit Akademik **(aneksi II.9)**. Bordi i Administrimit ka përgjegjësi të veçantë për miratimin e buxhetit **(aneksi IX.1.1)**, Rektorati zbaton planin strategjik të zhvillimit dhe operacionet e përditshme **(aneksi I.4)**, roli i Këshillit të Etikës përcaktohet edhe në rregulloren e tij **(aneksi II.12)** dhe Komitetet e Përhershme përcaktohen nga Senati **(aneksi I.9)** dhe kanë përgjegjësi specifike **(aneksi II.10, 11)**. Roli i Asamblesë së Personelit Akademik përcaktohet po ashtu në statut **(aneksi II.1)** dhe ajo po punon në mënyrë efektive, siç dëshkohet nga procesverbalet e mbledhjeve **(aneksi IV.16, 17)**. Dekanati merr vendimet e duhura në nivel Fakulteti **(aneksi IV.4)** dhe Këshilli i studentëve ka gjithashtu rol dhe përgjegjësi të mirë përcaktuara **(aneksi II.25, 25.1, aneksi VII.6.1, 6.3)**. Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se KU Logos ka organe drejtuese të cilat lehtësojnë marrjen e vendimeve duke favorizuar debatin në bordet e institucionit. *[Kapitulli III, Standardi II.3].*

1.9 KU Logos është pajtuar në revistën periodike Monitor **(aneksi XI.7.7)** dhe shqyrton raportet kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat i mban të përditësuara për zhvillimin ekonomik vendor, rajonal dhe ndërkombëtar. Zhvillimet e reja të programit **(aneksi III.4, 5)** propozohen në pas shqyrtimit të këtij informacioni nga ekspertët brenda institucionit dhe bien dakord me komisionin e cituar më sipër. Logos monitoron gjithashtu vendosjen e studentëve në praktika **(aneksi VII.5.3)** dhe punësimin e studentëve pas diplomimit për të mbledhur informacion rreth punësimit përmes zyrës së çështjeve studentore **(aneksi VII.5.1, 5.2)**. Prandaj, grupi i vlerësimit arrin në përfundimin se Logos zhvillon kërkim të tregut për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij. **[Kapitulli III, Standardi III.1].**

1.10 KU Logos bashkëpunon me Universitetin e Pireut dhe planifikon të vendosë marrëdhënie me Universitetin Ndërkombëtar Helenik, Universitetin Aristotel në Selanik dhe Universitetin Democritus të Thrakës **(aneksi VIII.3)**. Ai ka lidhur kontakte edhe me Universitetin e Janinës, Universitetin e Egjeut dhe Universitetin Evropian të Romës **(aneksi VIII.6.1, 6.2, 6.3)** me qëllim krijimin e marrëveshjeve dhe memorandumëve të mirëkuptimit. Plani është të zhvillohet një konsorcium institucionesh me aktivitete të përbashkëta, për shembull projekte kërkimore bashkëpunuese **(aneksi II.5.1)**, zhvillimin e qasjeve të reja pedagogjike **(aneksi VIII.4.11)** dhe platformat e reja të të nxëniet **(aneksi XI.5.1)**. Grupi i vlerësimit arrin në përfundimin se KU Logos po ndjek një strategji bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. **[Kapitulli III, Standardi III.2].**

1.11 KU Logos bashkëpunon me një sërë institucionesh private dhe publike në Shqipëri për t'u dhënë studentëve mundësi për të marrë pjesë në praktika dhe raste studimore **(aneksi VIII.1 -5)**. Logos nxit gjithashtu lëvizshmërinë e stafit dhe studentëve për të marrë pjesë në skemat e lëvizshmërisë përmes Erasmus+ **(aneksi IV.7.1)**. Stafi nxitet të marrë pjesë në konferenca dhe seminare ndërkombëtare **(aneksi V.4.1, 1.2, 1.5)** dhe të bashkëpunojë me institucione të tjera të arsimit të lartë **(aneksi VIII.6.1)**. Megjithatë, pandemia aktuale Covid-19 ka kufizuar ashpër mundësitë këtë vit. Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se KU Logos ndjek një strategji bashkëpunimi me institucione të tjera mbështetëse dhe një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar, por ky vit është kufizuar shumë për shkak të pandemisë Covid-19. **[Kapitulli III, Standardet III.3, III.4].**

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar të praktikës së mirë.

### **Dobësitë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

## **Rekomandime**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

## **Pohim i veprimeve të ndërmarra.**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- përpjekjet që po bëhen për të përfituar nga mundësitë që ofron skema Erasmus për lëvizshmërinë e studentëve (*paragrafi 1.4*), [*Kapitulli III, Standardi I.4*].

## **Gjykim**

Standardet për organizimin dhe menaxhimin janë **përbushur plotësisht**.



## Fusha e vlerësimit 2: Burimet

2.1 Struktura e KU Logos organizohet sipas statutit (**aneksi II.1**) dhe rregullores së përgjithshme (**aneksi II.2**). Organika (**aneksi II.7**) është në dispozicion të publikut në faqen e internetit të institucionit (<http://www.kulogos.edu.al/en/organigrama.html>). Para fillimit të çdo viti akademik, departamentet bëjnë llogaritjen e kërkesave të tyre për personel me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe ia paraqesin Dekanit, i cili më pas paraqet një kërkesë zyrtare tek Rektori (**M10**). Rekrutimi organizohet nga zyra e burimeve njerëzore sipas ligjit për arsimin e lartë, Kodin e Punës, statutin (**aneksi II.1**) si dhe rregulloret e përgjithshme (**aneksi II.2**) të KU Logos. Vendet e lira të punës publikohen në faqen e internetit të institucionit ([www.kulogos.edu.al/en/organigrama.html](http://www.kulogos.edu.al/en/organigrama.html)) sipas politikës dhe procedurës së për burimet njerëzore (**M5, M10, aneksi II.6.1**). Për shqyrtimin e aplikimeve ngrihen komisione të posaçme. Ato kryejnë intervista dhe njoftojnë kandidatët e kualifikuar dhe të s'kualifikuar (**M5, aneksi II.6.1, IV.4.1**). Si stafi akademik edhe ai mbështetës ka kontratë pune e cila detajon kushtet e punës (**aneksi IV.3, 3.1**). KU Logos favorizon rekrutimin e stafit akademik të diplomuar në universitete të njohura ndërkombëtarisht dhe që ka pasur sukses në këtë drejtim (**aneksi IV.6, IV.22**). Në përputhje me Planin strategjik të zhvillimit (**aneksi II.5.1**), KU Logos mbështet stafin për të marrë diploma të mëtejshme (**M5, aneksi IV.5, 6**) dhe siguron mbështetje financiare për personelin akademik që merr pjesë në konferenca shkencore dhe aktivitete kërkimore (**M5, aneksi IV.5**). Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në konkluzionin se KU Logos ndjek një politikë të hapur për punësimin dhe rekrutimin e burimeve njerëzore. **[Kapitulli III, Standardi IV.1].**

2.2 KU Logos miraton një plan vjetor (**aneksi IV.7, 7.1**) të aktiviteteve akademike dhe kërkimore, në fillim të çdo viti, i cili përfshin pjesëmarrjen në konferenca (**M5, aneksi IV.19, aneksi V.4.1.1, 4.1.2, V.6.1, 6.2, 6.3, 6.4**). Ditët e Informimit organizohen nga një njësi e dedikuar ad hoc për studentët dhe studentët e ardhshëm, dhe mbështeten nga stafi akademik dhe administrativ (**aneksi VII.3.2, 2.2**). Logos gjithashtu organizon aktivitete të tjera, si për shembull promovime librash, festime për festat kombëtare dhe ceremoni diplomimi, të cilat mundësojnë bashkëpunimin mes stafit (**M5, M6, aneksi IV.7, 10**). Prandaj arrihet në përfundimin se KU Logos ndjek një politikë të integritetit të stafit akademik, duke asistuar stafin mësimdhënës, stafin shkencor dhe stafin administrativ. **[Kapitulli III, Standardi IV.2].**

2.3 Strategjia e zhvillimit përcakton se trajnimi i stafit ka përparësi (**aneksi II.5.1**) dhe kjo arrihet përmes pjesëmarrjes në konferenca, botime shkencore, pjesëmarrje në komision dhe veprimtari trajnimi (**M5, aneksi V.4.1.1, 4.1.2, aneksi IV.7**). Vlerësimi i aftësive të stafit bëhet në fund të çdo viti akademik dhe ka një procedurë dhe objektiva të përcaktuara (**M5, aneksi II.6.1, aneksi IV.13**). Kjo gjë fillon me një vetëvlerësim të pasuar nga vlerësimi i Shefit të Departamentit sipas kontratës së punës (**M5, aneksi IV.3.1**). Pyetësorët e studentëve përdoren gjithashtu për të marrë mendime mbi cilësinë e mësimdhënies (**aneksi VI.3, 16**). Stafi administrativ vlerësohet nga Administratori duke përdorur një formular standard vlerësimi (**M6, aneksi IV.3**). KU Logos nxit lëvizshmërinë e stafit akademik përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet ndërkombëtare në kuadër të skemës Erasmus+ (**M5, aneksi VIII.1**). Gjatë viteve 2018-2019, 16 anëtarë të stafit në skema të tilla morën pjesë në Universitetin e Pireut, Universitetin Eklektik të

Selanikut dhe Universitetin e Oradeas në Rumani. Që atëherë pandemia Covid-19 e ka kufizuar këtë aktivitet, megjithëse janë kryer tre vizita **(M6, aneksi IV.7.1)**. Pedagogët e huaj kanë vizituar gjithashtu KU Logos për të mbështetur stafin akademik **(aneksi IV.7.1)**. Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se KU Logos ndjek një politikë të vlerësimit periodik të aftësive të stafit të tij. **[Kapitulli III, Standardi IV.3]**.

2.4 KU Logos organizon aktivitete sociale shtesë, për shembull për të rritur ndërgjegjësimin për dhurimin e gjakut dhe për të mbledhur fonde për njerëzit e prekur nga tërmeti i fundit në Shqipëri **(aneksi IV.10)**. Marrëveshjet e bashkëpunimit **(aneksi VIII.3)** konsiderohen edhe si kornizë për dialog social dhe shkëmbim njohurish dhe kulturash, si dhe përpjekjesh shkencore. Botimet e shtypura dhe paraqitjet televizive nga stafi akademik **(M5, aneksi VII.3.2)** dhe aktivitetet që lidhen me tolerancën fetare **(aneksi V.5.1)** janë gjithashtu një mjet për promovimin e dialogut social. KU Logos trajton shëndetin dhe sigurinë e stafit të saj si një aspekt me përparësi dhe ka pajtuar ekspertë të jashtëm **(M5, aneksi X.8)** për të siguruar trajnim dhe mbështetje **(aneksi IV.7, X.8.1)**. Ambientet janë të inspektuara dhe certifikuara për sigurinë **(aneksi X.4, 4.1, 4.2, 7)** dhe, së fundmi, instituti është në përputhje me Rregulloren e Brendshme për mbrojtjen nga Covid-19 **(aneksi II.18)**. KU Logos ka gjithashtu një dhomë infermierie me një mjek të caktuar **(aneksi X.8.2)** dhe stafi është i mbuluar me sigurim të jetës dhe shëndetit. **[Kapitulli III, Standardi IV.4]**.

2.5 Zyra e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me të gjitha departamentet e tjera, bashkërendon veprimtarinë e burimeve njerëzore të institucionit sipas statutit **(M6, aneksi II.1)**, rregullores së përgjithshme të institucionit **(M6, aneksi 11.2)** dhe udhëzimeve të Rektorit **(aneksi IV.18)**. Si personeli akademik ashtu edhe ai administrativ kanë një kontratë individuale pune **(M5, M6, aneksi IV.3, 3.1)**, e cila përcakton rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të stafit dhe të punëdhënësit. Grupi i vlerësimit arrin në përfundimin se KU Logos zbaton rregulla të qarta për të përcaktuar përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse. **[Kapitulli III, Standardi II.2]**.

2.6 KU Logos garanton stabilitet financiar të të ardhurave përmes tarifave të studentëve dhe donacioneve të Fondacionit Logos (DVV). Buxhetet përgatiten duke marrë parasysh nevojat e departamenteve dhe fakulteteve duke përdorur procedura të përcaktuara bazuar në Udhëzimin për hartimin e buxhetit **(M6, aneksi IX.2, 2.1)** si dhe rregulloren e përgjithshme **(aneksi II.2)**. Më pas, buxheti miratohet nga Senati dhe, në fund, nga Bordi i Administrimit (M10, M12). Prandaj, institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara. **[Kapitulli III, Standardi VI.1]**.

2.7 Sipas statutit **(aneksi II.1)**, administratori është përgjegjës për zbatimin e procedurave të duhura financiare **(M12)**. Zyra e financës funksionon sipas rregullores **(aneksi II.22)**. Kryen funksionet e nevojshme, si lëshimi i faturave të studentëve, kryerja e pagesave dhe përgatitja e pasqyrave financiare. Çdo gjashtë muaj përgatitet një raport financiar për Administratorin për të siguruar që buxheti zbatohet siç është planifikuar dhe për të kryer çdo rregullim që mund të jetë i nevojshëm **(M6, M12, DVV)**. KU Logos planifikon të krijojë një zyrë të auditit të brendshëm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave **(DVV)** dhe Fondacioni Logos ka një kontratë me një audit të jashtëm për të audituar dhe certifikuar pasqyrat financiare **(aneksi IX.3, 3.1)**. **[Kapitulli III, Standardi VI.2]**.

2.8 Administratori dhe zyra e financës monitorojnë vazhdimisht pozicionin financiar dhe raportojnë tek Bordi i Drejtorëve çdo vit **(DVV, M6, M12)**. Raporti i auditit të të jashtëm i paraqitet edhe Bordit të Drejtorëve **(aneksi IX.3, 3.1)** së bashku me pasqyrat financiare. Ky raport i paraqitet edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve **(aneksi IX.4, 4.1, 4.2)**. Raportet vjetore **(aneksi II.26.1 -3)** janë të lidhura ngushtë me pozicionin financiar, objektivat institucionale dhe sigurojnë që burimet njerëzore dhe fizike të pasqyrohen në pasqyrat financiare. KU Logos ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar. **[Kapitulli III, Standardi VI.3].**

2.9 KU Logos ka një faqe interneti gjithëpërfshirëse ([www.kulogos.edu.al](http://www.kulogos.edu.al)), e cila përmban hollësi rreth statutit dhe rregulloreve, strukturës akademike, politikave dhe procedurave, programeve të ofruara, kërkimeve, shërbimeve, të rejave dhe mediat. Studentët gjithashtu mund të kenë qasje në informacionin përkatës, siç janë oraret **(M3, M4, aneksi VII.11)**, përmes portalit të studentëve **(M3, M4)**. KU Logos përdor kanalet e mediave sociale për të komunikuar me studentët dhe palët e tjera të interesuara (<https://www.facebook.com/shlplogostiranealbania>). Institucioni ka një sistem të menaxhimit të informacionit të mbrojtur me fjalëkalim, i cili mundëson, për shembull, komunikimin me studentët, regjistrimin, notat e studentëve, informacionin e kurrikulës dhe oraret e mësimit që të jenë në dispozicion në mënyrë elektronike. KU Logos ka tre laboratorë kompjuterik si dhe kompjuterë të vendosur në dispozicion në biblioteka, si për stafin ashtu edhe për studentët **(M3, M4, M5, M6, turne)**. Për mësimdhënien dhe të nxënit, institucioni ka pajtuar Microsoft Office 365 dhe ka qasje në Word, Excel, PowerPoint, Outlook dhe Teams si për stafin ashtu edhe për studentët **(M3, M4, M5, aneksi XI.5.2, 5.4, 5.5)**. Megjithëse kjo teknologji është zbatuar para pandemisë Covid-19, grupi i vlerësimit **pohon hapat që po ndërmerren për zhvillimin e burimeve online për të mundësuar vazhdimin e mësimit gjatë pandemisë Covid-19. [Kapitulli III, Standardi VII.1, VII.2].**

2.10 KU Logos ka dy kampuse, të cilat janë në pronësi të themeluesit sipas marrëveshjeve të kredisë **(aneksi X.5, 5.2)**. Siguria fizike dhe e shëndetit menaxhohen përmes një sistemi për fikjen e zjarrit, një sistem alarmi, një sistem audio qendror dhe shoqëritë e sigurisë të kontraktuara **(DVV, turne)**. Infrastruktura është përmirësuar vazhdimisht gjatë viteve të fundit për shkak të rritjes dhe zhvillimit dhe kjo është siguruar nga Fondacioni **(aneksi X.5.1). [Kapitulli III, Standardi V111.3].**

2.11 Të dhënat akademike, kulturore dhe shkencore ruhen në mënyrë elektronike në arkiv **(aneksi II.20)** që menaxhohet nga zyra e protokollit **(turne)**. Institucioni ruan në bibliotekë kopje fizike **(turne)** të botimeve, mediat dhe punimet e stafit dhe studentëve **(aneksi V.4.1.1, 2.5, 5.1, 5.3.1, 2, V6). [Kapitulli III, Standardi VII.4].**

2.12 KU Logos ka infrastrukturë të përshtatshme për të kryer aktivitetet e tij. Këtu përfshihen, për shembull, hapësira e zyrës, pajisjet e zyrës, klasat e leksioneve, klasat e seminareve, klasat e kompjuterëve dhe bibliotekat **(M5, turne, aneksi X.5, aneksi X.4.2)**. Ato përbushin standardet fizike dhe kimike të përcaktuara nga shteti dhe janë në gjendje të kryejnë funksione me interes të përbashkët, të tilla si konferenca të përbashkëta me organizata të tjera **(M5, aneksi X.5, 5.2, 8.1). [Kapitulli III, Standardi VII.5, VII.6].**

2.13 KU Logos ka dy kampuse. Kampusi 1 në Tiranë strehon Fakultetet e Ekonomisë, Shkencave të Aplikuara dhe Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit

Gjuhësor, ndërsa Kampusi 2 që është jashtë qytetit strehon Departamentin e Teologjisë dhe Kulturës (**turne**). Këto godina ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të institucioneve dhe përmbushin standardet e nevojshme të higjienës, ndriçimit, zhurmës, temperaturës, lagështirës dhe hapësirës. (**turne**). Ato janë vendosur në zona pa zhvillim industrial dhe ndotje (**turne, aneksi X.2, 2.1, 2.2, 3, 8.1**). Gjithashtu, personat me aftësi të kufizuara mund të hyjnë në godina përmes rampave dhe ashensorëve dhe kanë mjedise të përshtatshme për tualete (**turne**). Ka edhe një palestër të pajisur mirë me dhoma ndërrimi, tualete dhe dushe dhe një sallë konferencash me kapacitet për 185 persona të ulur. Në përgjigje të pandemisë Covid 19, institucioni ka siguruar edhe gjashtë klasa virtuale për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit (**turne**). [*Kapitulli III, Standardi V.1*].

2.14 Zyra e arkiv-protokollit ruan gjithë dokumentacionin në kopje të printuara sipas rregullores së arkiv-protokollit (**turne, aneksi II.20**). Ruajtja e të gjitha të dhënave elektronike të prodhuara nga institucioni është, gjithashtu, objekt i procedurave dhe protokolleve të sigurisë (**aneksi X.8.3.1, 8.3.2**). Ka një plan rimëkëmbje përmes ruajtjes (backup) në re (**aneksi X.8.3.3**). Rregullorja e përgjithshme (**aneksi II.2**) parashikon ruajtjen e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale (**aneksi II.17**). Administratori i fakultetit dhe sekretaria mësimore janë përgjegjës për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave, të cilat përfshijnë të dhëna të studentëve, si regjistri dhe notat, si dhe informacion në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënit. Të dhënat personale ruhen në përputhje me rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale (**aneksi VII.4.10, 9.1**). [*Kapitulli III, Standardi V.2*].

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar të praktikës së mirë.

### **Dobësitë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

### **Pohim i veprimeve të ndërmarra.**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- Përpjekjet e bëra për zhvillimin e burimeve online për të mundësuar vazhdimin e mësimin gjatë pandemisë Covid-19 (*paragrafi 2.9*). [*Kapitulli III, Standardi VII.1, VII.2*].

## Gjykim

Standardet për burimet janë **përmbushur plotësisht.**

### Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 KU Logos ndjek politika të qarta në lidhje me informacionin rreth programeve mësimore **[aneksi III.1.1-III.10]** që ai ofron. Studentët informohen nga stafi akademik, njësitë bazë në bashkëpunim me zyrën për mbështetjes së studentëve dhe këshillimit për karrierë dhe nga grupi i këshillimit të karrierës dhe rekrutimit të studentëve **[M5, M6, aneksi IV.11, II.24]**. Pas vendimit të Senatit Akademik, u krijua një grup pune i cili fokusohet në zbatimin e një plani veprimi për organizimin e takimeve informuese me nxënësit e shkollave të mesme dhe koordinimin me departamentet dhe stafin akademik për organizimin e prezantimeve në rrethe **[aneksi I.6]**. Stafi akademik është pjesë e këtyre aktiviteteve **[aneksi IV.10]**. Informacioni në faqen e internetit **[aneksi XI.1, XI.3]** broshurat, fletëpalosjet **[aneksi XI.4.1]**, takimet me shkollat e mesme gjatë periudhës mars - maj **[aneksi IV.11]** janë ndër instrumentet që përdoren nga institucioni për informimin e publikut për programet mësimore. KU Logos ka nënshkruar memorandume me 7 shkolla të mesme teknike në rajonin e Tiranës, Korçës, Gjirokastrës dhe Durrësit, ku në fokus është planifikimi i vizitave çdo dy muaj sipas datave të përcaktuara, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve për programet e studimit të ofruara **[aneksi VIII.5]. [Kapitulli I, Standardi I.1].**

3.2 Veprimtaria e KU Logos bazohet në misionin e përcaktuar në statut dhe Strategjinë e Zhvillimit 2018-2024 **[aneksi II.1, II.8, II.5.1.1]**. Puna bazohet në procesin mësimor, duke u përqendruar tek studentët, vlerësimin dhe mbështetjen e stafit akademik, promovimin e barazisë dhe vlerësimin e diversitetit **[aneksi II.1, aneksi Nr. II.8]**. Aktiviteti mësimor zhvillohet në tre Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti i Shkencave Humane **[aneksi I.15]**. KU Logos ka përcaktuar qartë në statut dhe rregullore kriteret për pranimin e studentëve **[aneksi II.1, II.2, III.1-III.10]**. Pranimi i studentëve bëhet sipas dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi, në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore **[aneksi II.1]. [Kapitulli I, Standardi I.1].**

3.3 KU Logos ofron një program studimi 2 vjeçar, tetë programe studimi me kohë të plotë në ciklin e parë Bachelor dhe dy programe në ciklin e dytë Master profesional **[aneksi III, aneksi III.0]**. Përparësitë e programeve mësimore (kurrikulave) shprehen në strategjinë 2018-2024 të institucionit, në strategjitë e tre Fakulteteve dhe në planet e zhvillimit të departamenteve. Programet e studimit janë ndërtuar mbi pesë komponentë, të cilët shprehin shpërndarjen e ngarkesës, përmbajtjen dhe trajnimet, sipas udhëzimeve dhe përcaktimeve ligjore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. **[aneksi III.2, aneksi III.3]. [Kapitulli I, Standardi I.1].**

3.4 Çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriteret e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave **[aneksi II.1]** mund të pranohet në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Kriteret e pranimit janë në përputhje me ligjin në fuqi. Programi i ciklit të parë për “teknik i lartë në laborator mjekësor” ka si kriter shtesë notën mesatare 6 për grupin e kurseve: kimi, fizikë, biologji dhe gjuhë të huaj **[aneksi II.4.6]**; programi i ciklit të dytë për “teknikë të lartë në laborator mjekësor” ka si kriter shtesë notën mesatare 6 në grupin e kurseve: mikrobiologji, kimi dhe biologji **[aneksi II.4.2]**; programi i studimit të ciklit të parë për “Informatikë të Zbatuar” ka si kriter shtesë notën mesatare 6 në grupin e lëndëve: matematikë, TIK, informatikë dhe gjuhë e huaj **[aneksi II.4.5]** ndërsa programet e tjera kanë vetëm kriteret e përgjithshme pranimi me notë mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave **[aneksi II.2, II.4.1,**

**II.4.3, II.4.4, II.4.7, II.4.9, II.4.10].** Regjistrimi i studentëve bëhet në kancelari. Të dhënat e regjistrimit dhe pajisja e tyre me një numër matrikulli mbahen në Regjistrin Bazë të printuar dhe në formë elektronike [aneksi VII.9.3, VII.9.4, VII.9.2]. Kancelaria vepron në bazë të një rregullore të miratuar nga Senati Akademik [aneksi II.21]. Të dhënat personale të studentëve arkivohen dhe ruhen në formë elektronike dhe të shkruar dhe administrohen nga sekretaria [aneksi II.1, VII.9.3, VII.9.4]. Procesi i regjistrimit përfshin gjithashtu nënshkrimin e një kontrate mes institucionit dhe studentëve [aneksi VII.8.1]. Programet i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme për të përmbushur objektivat e përcaktuara në Strategjinë e institucionit, Strategjinë e Fakulteteve dhe programeve [M2, M10, aneksi III.7.1, III.7.3, III.7.2]. **[Kapitulli I, Standardi I.1].**

3.5 KU Logos punon për të ofruar programe edukimi në vijimësi [aneksi III.6]. Për të përmbushur përparësitë dhe kërkesat e Ligjit 80/2015, neni 81, Departamenti i Shkencave Mjekësore ka propozuar trajnime në ekokardiografi, trajnime në teknikat laboratorike dhe mjekësore, dhe trajnime për akreditimin e laboratorëve mjekësorë sipas ISO 15189. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor është i fokusuar në organizimin e kurseve të mentorimit për studentët, kurse për teologjinë, trajnimin e përdoruesve të bibliotekës dhe kurse të gjuhës greke për fillestarët [aneksi III.6]. Institucioni ka nënshkruar shtatë marrëveshje bashkëpunimi me shkollat e mesme të përgjithshme dhe teknike përmes të cilave KU Logos ofron trajnim për stafin mësimdhënës si dhe përdorimin e pajisjeve laboratorike [aneksi VIII.5]. Gjithashtu janë zhvilluar disa konferenca si: “Konferenca për zhvillimin profesional të mësuesve të ciklit parashkollor”; “Mësimdhënia për fëmijët me aftësi të kufizuara” [aneksi V.1.2]. KU Logos ka organizuar dy konferenca ndërkombëtare dhe një konferencë studentore gjatë periudhës 2017-2018; dy konferenca ndërkombëtare, një konferencë kombëtare, një konferencë studentore, një tryezë të rrumbullakët dhe 11 leksione të hapura gjatë periudhës 2018-2019; 17 leksione të hapura dhe 15 aktivitete në kuadër të zhvillimit institucional gjatë periudhës 2019-2020. Për vitin 2020-2021, kurset e trajnimit dhe konferencat janë pezulluar për shkak të situatës së Covid-19 [aneksi II.26.1, II.26.2, II.26.3]. **[Kapitulli I, Standardi 1.2].** Komisioni i kurrikulave, njësia e sigurimit të cilësisë, zyra e çështjeve studentore dhe e këshillimit për karrierë dhe departamentet vlerësojnë përvojën e fituar nga projektet dhe konferencat kërkimore dhe i pasqyrojnë ato në masën 20% [M5, M6] **në përmbajtjen e kurrikulave gjatë përmirësimeve periodike. [Kapitulli I, Standardi 1.2].**

3.6 Në Statutin e KU Logos, misioni i tij përcaktohet si: “Të zhvillojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në mënyrë që të sigurojë një arsimim bashkëkohor për studentët; [aneksi II.1]. Në këtë kuadër, programet e studimit përshtaten dhe zhvillohen paralelisht me strategjinë për zhvillimin e KU Logos, duke synuar formimin dhe përgatitjen e studentëve në përputhje me tendencën e tregut të punës dhe në shërbim të zhvillimeve dinamike. Përpjekja e KU Logos drejt transformimit shprehet në Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2024 [aneksi II.5.1], i cili zbatohet në planet strategjike të fakulteteve dhe departamenteve. [aneksi II.5.2, II.5.3, II.5.4, II.5.5]. **[Kapitulli I, Standardi 1.3].**

3.7 Programet e studimit janë ndërtuar në përmbushje të objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2024 të institucionit [aneksi II.5.1]. Këto objektiva pasqyrojnë zhvillimet kombëtare ekonomike dhe teknologjike [M2, M10]. Ndryshimet në përmbajtjen e programeve bazohen në kërkesat e tregut të punës [M5, M7, M10]. **[Kapitulli I, Standardi 1.4].**

3.8 KU Logos ka një infrastrukturë moderne që mundëson zbatimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor [turne]. KU Logos ofron një infrastrukturë me mjedise teknike duke përfshirë tetë salla leksionesh, 14 salla seminaresh, 11 laboratorë, 2 biblioteka (në kampusin kryesor dhe në kampusin e Shën Vlashit), një sallë të madhe konferencash, si dhe teknologji të mësimdhënies moderne. Për mësimdhënien në laborator, janë në dispozicion 3 laboratorë mjekësorë (laboratori biokimik-klinik, laboratori mikrobiologjik dhe laboratori histopatologjik);

5 laboratorë informatikë, një laborator për gjuhën greke dhe një për pedagogjinë **[aneksi II.26.1; II.26.2,II.26.3]. [Kapitulli I, Standardi 1.5].**

3.9 KU Logos po rrit numrin e stafit akademik me tituj. Për vitin akademik 2017-2018, kishte shtatë profesorë, 16 lektorë dhe 27 asistentë. Në vitin 2018-2019, kishte 24 profesorë, 31 lektorë dhe 32 asistentë lektorë. Në vitin 2019-2020, kishte 37 profesorë, 45 lektorë dhe 39 asistentë lektorë. Për personelin mësimor të punësuar me kohë të plotë, ka një rritje të numrit të personelit akademik me titullin “Profesor”, përkatësisht nga shtatë në periudhën 2017-2018 në 11 për vitin akademik 2018-2019, i cili mbetet i pandryshuar edhe për vitet 2019-2020. Ka një rritje të numrit të stafit mësimor me gradën “Lektor” nga 16 gjatë periudhës 2017-2018 në 45 gjatë vitit akademik 2019-2020 **[M2, M6, M10, aneksi II.26.1, II.26.2, II.26.3]. [Kapitulli I, Standardi 1.5].**

3.10 Programet e studimit janë ndërtuar me objektiva të qarta që shprehin qëllimet e institucionit në Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2024 **[aneksi II.23.1].** Gjashtë prioritetet strategjike të institucionit pasqyrohen në objektiva afatshkurtra dhe afatgjata të fakulteteve dhe në kurrikulën e programeve të studimit **[M2, M10, aneksi II.5.1].** Objektivi i përgjithshëm i programeve është të nxisin metoda të ndryshme inovative në mësimdhënie dhe mësimnxënie, të rrisin numrin e studentëve, ndërsa në periudhën afatmesme dhe afatshkurtër secili program ka objektiva specifike. Programi “teknik i lartë në laborator mjekësor” synon përmirësimin e kushteve laboratorike nëpërmjet krijimit të laboratorit të ri të histopatologjisë, imunologjisë, si dhe forcimin e përmbajtjes së programit në fushën e imunologjisë. Ndërkohë në planin afatgjatë objektivi i Fakultetit të Ekonomisë është përshtatja e metodave bashkëkohore të mësimdhënies për t’iu përgjigjur dinamikës së ndryshimeve në zhvillimet ekonomike brenda dhe jashtë vendit dhe hartimi i kurrikulës për ciklin e dytë të studimeve “Master shkencor” në fushën e financë- kontabilitetit **[aneksi II.5.2-II.5.7]. [Kapitulli I, Standardi 1.6].**

3.11 Prioriteti nr. 1, objektivi nr. 1 i planit strategjik të zhvillimit 2018-2024 synon “Të transformojë strukturën institucionale nga kolegji në universitet në mënyrë që të përmbushet vizioni dhe misioni i institucionit” **[aneksi II.5.1].** Institucioni ka bërë përpjekje për hapjen e programeve të reja. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka planifikuar të hapë një Master të ri shkencor për programin “financë– kontabilitet” **[aneksi II.5.4].** Në nëntor 2018, KU Logos aplikoi për hapjen e dy programeve të reja të studimit në ciklin e dytë për farmaci dhe Master shkencor në inxhinieri finance, por të dyja nuk kanë marrë ende miratimin përfundimtar, megjithëse janë vlerësuar pozitivisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit **[aneksi II. 26.2].** Për vitin 2020, janë bërë aplikime për hapjen e dy programeve të reja në ciklin e parë për mësuesi; Master i shkencave për “studime përkthimi” **[aneksi III.4]** i cili do të bëjë të mundur që studentët që mbarojnë programin “Bachelor në gjuhë dhe qytetërim grek” të vijojnë studimet në ciklin e dytë. Deri më tani, kalimi nga cikli i parë i studimeve në ciklin e dytë të Masterit profesional ofrohet vetëm për dy programe, përkatësisht financë- kontabilitet dhe Master në teknikat e avancuara në laborator mjekësor. **Grupi i vlerësimit pohon përpjekjet që po bëhen për hapjen e programeve të reja të Masterit shkencor me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së procesit arsimor. [Kapitulli I, Standardi 1.7].**

3.12 Tetë programet e studimit në ciklin e parë Bachelor janë ndërtuar me një shpërndarje të drejtë të teorisë me praktikën **[aneksi III].** Programe të tilla si “teknik i lartë në laborator mjekësor”, “Informatikë e zbatuar” i japin rëndësi orëve laboratorike. Gjatë takimit me stafin akademik u dhanë disa shembuj për programin “financë- kontabilitet”, ku përdorimi i softuerit Financë 5 dhe Alpha Business në orët laboratorike në klasë gjatë periudhës së

pandemisë u kishte mundësuar studentëve të fitonin njohuri të thella praktike. **[M3, M5]. [Kapitulli I, Standardi 1.7].**

3.13 Studentët informohen për procedurën e transferimit, e cila pasqyrohet qartë në rregulloren e institucionit, rregulloret e Fakulteteve dhe programet e studimit **[aneksi II.2, II.3.1, II.3.2, II.3.3]**. Rregullorja e transferimit është rishikuar në vitin 2019, në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe pasqyron kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve në programe të ngjashme brenda KU Logos ose në universitete të ndryshme brenda ose jashtë vendit **[aneksi II.15]**. Kancelaria administron të dhënat e studentëve të transferuar dhe numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe të transferuar pasqyrohet në raportet vjetore të departamenteve dhe institucionit **[aneksi II.26.3, II.26.2, II.26.1, VII.2.4]. [Kapitulli I, Standardi 1.7].**

3.14 Studentët informohen për vazhdimin e studimeve nga programet e ciklit të parë në ato të ciklit të dytë. Gjatë takimit me ish-studentë dhe studentë u mblodhën shembuj në këtë drejtim **[M3, M7]**. Programet e studimit i nënshtrohen rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Shumica e studentëve në fund të studimeve të ciklit të parë kanë mundësi punësimi **[aneksi II.26.3]**. Tek studentët e ciklit të dytë të studimeve vihet re një shkallë më e lartë punësimi. Kjo është në përputhje edhe me kërkesat aktuale të tregut të punës për të diplomuarit nga programet e ciklit të dytë. **[aneksi II.26.3]. [Kapitulli I, Standardi 1.7].**

3.15 KU Logos ofron proces tutorimi për studentët **[aneksi VII.4.6]**. Çdo departament ka caktuar një lektor, i cili është përgjegjës për trajtimin e problemeve që hasin studentët **[M3, M4, M5]**. Raporti një lektor për çdo tre studentë krijon mundësinë e një komunikimi të ngushtë mes stafit akademik dhe studentëve **[M5, aneksi II.26.3]**. Për më tepër, zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit për karrierë mbështet progresin e studentëve përmes aktiviteteve të saj **[aneksi II.24, VII.2.6]**. Departamenti i Teologjisë Sociale dhe Studimeve Fetare dha si shembull programin e mentorimit “Ndërto karrierën tënde”, i cili konsiston në mbledhjen e të dhënave në një bazë të dhënash, në dhënien e udhëzimeve për përgatitjen e CV-ve bazuar në kualifikimet e studentëve dhe koordinimin e tyre në aktivitete specifike. Për vitin akademik 2021-2022, pritet të zbatohet një program bashkëpunimi, sipas të cilit studenti do të ketë mundësi të bashkëpunojë me pedagogun për një orë në javë. Orari i këtij programi do të shpallet në javën e dytë të çdo semestri **[aneksi II.26.5]. [Kapitulli I, Standardi 1.8].**

3.16 Përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies, është një nga objektivat afatshkurtër të departamenteve. Çdo vit programet e studimit i nënshtrohen përmirësimit në masën 20%. **[M5, M10, aneksi II.5.2-5.5]**. Teknikat e mësimdhënies përshkruhen qartë në syllabusin e secilës lëndë **[aneksi III.1.1-1.11]**. Stafi akademik është i angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të teknikave të mësimdhënies **[M5, M10]**. Në këtë drejtim, institucioni ka ofruar mbështetje për plotësimin e nevojave me infrastrukturë në përputhje me standardet. Për vitin akademik 2020-2021, janë bërë përshtatje për mësimin në distancë. Ndër format më të përdorshme janë platformat e mësimin online, ngarkimi i materialit mësimor në platforma dhe librat në platforma elektronike, prezantime, video, detyra dhe teste. Komunikimi është përmirësuar përmes përdorimit të rrjeteve sociale. Departamenti kryen monitorimin javor të materialeve të ngarkuara, progresin në secilin modul, vlerësimin dhe çështjet e nxjerra në pah nga studentët **[M3, M4, M5, M10, aneksi VII.4.11]. [Kapitulli I, Standardi 1.8].**

3.17 KU Logos ka pajtuar 51 personel akademik në total (7 profesorë, 5 profesorë të asociuar, 18 doktorë shkencash dhe 21/5 me Master/ doktoratë në proces ) për vitin akademik 2020-2021 **[aneksi IV.2.4]**. Raportet vjetore të institucionit dhe departamenteve shprehin përpjekjet e bëra nga institucioni për të rritur numrin e stafit akademik me tituj,



megjithëse disa departamente po hasin vështirësi në procesin e rekrutimit [aneksi II.26.4 - 26.6]. KU Logos i kushton rëndësi të madhe rekrutimit të stafit akademik me përvojë. Institucioni synon të rekrutojë staf të kualifikuar. Për vitin akademik 2018-2019, 14 nga 40 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, ose 35%, ka përfunduar të paktën një cikël studimesh në një universitet ndërkombëtar. 14 nga 47 anëtarë të stafi akademik me kohë të pjesshme, ose 30%, ka përfunduar të paktën një cikël studimesh në një universitet ndërkombëtar **[aneksi IV.6]**. Ngarkesa e stafit akademik aktual është brenda kufijve ligjorë të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit **[aneksi IV.1, IV.2, IV.2.1, IV.2.2, IV.2.3]**. Bazuar në evidencat dhe takimet me stafin mësimor, grupi i punës arrin në përfundimin se ngarkesa mësimore prej 70% është plotësuar nga akademikë me kohë të plotë dhe se kjo ngarkesë nuk e pengon stafin akademik në punën e tij kërkimore shkencore. **[Kapitulli I, Standardi 1.8]**.

3.18 Politikat për rekrutimin e stafit akademik janë përcaktuar në statut, rregulloret e institucionit, rregulloret e fakulteteve dhe rregulloret e zyrës së burimeve njerëzore. **[aneksi II.1, II.2, II.6, IV.4]**. Procedurat janë transparente dhe zbatohen me korrektësi. Për sa i përket rekrutimit, synohet personel që të ketë të paktën nivelin doktor dhe me përvojë në praktikë dhe mësimdhënie. Disa degë të veçanta si “informatika e zbatuar” dhe “teknik i lartë në laborator mjekësor”, po hasin vështirësi në rekrutimin e stafit me përvojë. Rekrutimi i stafit mbështetës - akademikët është fokusi i KU Logos. Ka raste të studentëve të diplomuar që rekrutohen nga ky Kolegj si staf mbështetës **[M4, M6, turne]**. Çdo departament përbëhet nga 5 anëtarë të stafit akademik në bazë të marrëveshjes së dhënë në korrik 2019 nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve **[aneksi I.5]**. **[Kapitulli I, Standardi 1.8]**.

3.19 Aktualisht KU Logos ofron dy programe të ciklit të dytë, përkatësisht Master Profesional në “financë dhe kontabilitet” dhe Master profesional në “teknikë të avancuara në laborator mjekësor”. Referuar kurrikulave, programet e studimit organizohen në module dhe vlerësohen me kredite në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS). Programet në ciklin Bachelor ofrohen me 180 kredite, ndërsa programet në ciklin e dytë ofrohen me 60 kredite dhe një program 2 vjeçar për arsimin parashkollor me 120 kredite. Programet e studimit janë në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve [aneksi nr. III.3] dhe studentët po fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca në fushat e mëposhtme: financë- kontabilitet, laboratorë mjekësorë, menaxhim turizmi, menaxhim biznesi, gjuhë greke dhe shkenca teologjike e fetare. Në të dyja programet Master profesional, stafi akademik që jep mësim ka minimumi një diplomë doktorate. **[aneksi III.1.1, III.1.2]**. **[Kapitulli I, Standardi 1.9]**.

3.20 Praktika profesionale çmohet e rëndësishme dhe parashikohet nga të dyja programet në kategorinë D me 6 kredite, si dhe vlerësohet me 60 orë ushtrime dhe 90 orë laborator për programin Master profesional në “teknikë të lartë për laborator mjekësor”, ndërsa vlerësohet me 120 orë laborator për programin Master profesional në “financë – kontabilitet” **[aneksi III.1.1.-1.11]**. Institucioni mban të dhëna të rregullta për punësimin e studentëve të diplomuar. Numri i studentëve të punësuar në fushat e tyre pas diplomimit është i lartë. Pas studimeve Master profesional për “financë– kontabilitet”, 9 nga 15 studentë të diplomuar janë punësuar sipas fushës së tyre të studimit (60%). Pas studimeve Master profesional për “teknik i lartë për laborator mjekësor”, 18 nga 27 studentë të diplomuar janë punësuar në fushën e tyre të studimit (66.7%) **[aneksi VII.5.1, II.26.4, II.26.3]**. **[Kapitulli I, Standardi 1.9]**.

3.21 Programet e studimit të ofruara nga KU Logos janë në përputhje me parimet e procesit të Bolonjës **[aneksi II.2]**, dhe nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve **[aneksi III.2, III.3]**. Institucioni ka shembuj të lëvizshmërisë së studentëve në kuadër të Erasmus + (lëvizshmëria për studentët dhe stafin). Sipas marrëveshjes ndër-institucionale 2018-2021, dy studentë nga Universiteti Oradea Rumani dhe dy studentë nga ky universitet

në Shqipëri përfituan nga këto shkëmbime **[aneksi V.7.3.1]**. Programet e studimit ofrohen në gjuhën greke dhe angleze, gjë që lehtëson lëvizshmërinë e studentëve në universitete të tjera. **[aneksi III.1.1-1.11]. [Kapitulli I, Standardi 1.10].**

3.22 Programet e studimit janë ndërtuar në një formë dhe përmbajtje e cila nxit marrjen e njohurive praktike të studentit. Raporti teori-praktikë luhetet mesatarisht 51-53% nga teoria në 47-49% nga praktika. Një vëmendje e veçantë i kushtohet programit “teknikë e avancuar në laborator mjekësor”, ku praktika në programin e ciklit të parë zë 57%, ndërsa në programin e ciklit të dytë zë 49%. Në programin dyvjeçar “mësuesi e ciklit parashkollor”, praktika zë 62.5%; në programin e ciklit të dytë “financë– kontabilitet”, praktika zë 53% kundrejt 47% teori, gjë që thekson fokusin e institucionit në zhvillimin e njohurive praktike, siç u deklarua edhe gjatë takimit me studentë dhe ish-studentë **[M3, M4, M5, M7]**. Sistemi i vlerësimit bëhet sipas krediteve evropiane, i cili është i vlefshëm **[aneksi III.1.1-1.11]. [Kapitulli I, Standardi 1.11].**

3.23 Rregullorja e departamenteve përcakton procedurën për përgatitjen e temës së diplomës kur studentit përmbush kriteret e mesatares së lartë të përcaktuar nga departamenti. Përveç temës së diplomës, kryhet edhe një provim përfundimtar nga një komision i posaçëm i ngritur në departament **[aneksi II.2, II.3.1-3.4]**. Stafit akademik ofron asistencë për studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës. Fusha e kërkimit të temës së diplomës është në përputhje me përvojën e stafit akademik. Mbrojtja bëhet përpara një komisioni të miratuar nga departamenti **[M4, aneksi II.2, II.3.1-4.10]. [Kapitulli I, Standardi 1.11].**

3.24 Departamentet në bashkëpunim me zyrën e çështjeve studentore dhe këshillimit për karrierë kanë organizuar aktivitete kulturore dhe sociale me studentët. Numri i këtyre aktiviteteve është ulur gjatë vitit akademik 2020–2021, për shkak të Covid-19. Vlen të përmendet ndihma që studentët dhanë për familjet e prekura nga tërmeti, në Durrës **[M6, M7]. [Kapitulli I, Standardi 1.11].**

3.25 Numri i përgjithshëm i studentëve të punësuar në fund të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve është mesatarisht i lartë **[aneksi II.26.1-26.3]**. Bashkëpunimi mes KU Logos, institucioneve shtetërore dhe shoqërive private përmes zhvillimit të praktikave profesionale ka ndikuar pozitivisht në normat e punësimit. Studentët e diplomuar në programin Master profesional në “financë– kontabilitet” dhanë shembuj që janë punësuar pas praktikës së kryer në shoqërinë “Helious System” **[M7]**. Bilanci mes teorisë dhe praktikës ka bërë që studentët të trajnohen në fushën e praktikës duke përmbushur kërkesat e tregut të punës **[M2, M5, M7, M10]. [Kapitulli I, Standardi 1.12].**

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë tipar të praktikës së mirë.

### **Dobësitë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

## **Rekomandime**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

## **Pohim i veprimeve të ndërmarra.**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Grupi i vlerësimit *pohon* përpjekjet që po bëhen për hapjen e programeve të reja të Masterit shkencor me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së procesit arsimor (*paragrafi 3.11) [Kapitulli I, Standardi 1.7]*.

## **Gjykim**

Standardet për kurrikulat janë **përbushur plotësisht**.

## **Fusha e vlerësimit 4: mësimdhënia, të nxënit, vlerësimi dhe kërkimi**

4.1 KU Logos ofron dy programe Master profesional, tetë programe Bachelor dhe një program dy-vjeçar **[aneksi II.1.1-1.11]**. Programet janë ndërtuar në bazë të ligjeve dhe kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë. Programet janë ngritur sipas kornizës me katër komponentë: lëndët bazë- kategoria A- me 27-36 kredite për nivelin Bachelor, dhe 3-6 kredite për nivelin Master profesional; kurset e profilizuara- kategoria B- me 90-99 kredite për nivelin Bachelor, dhe 18-24 kredite për nivelin Master profesional; kurset integruese ndërdisiplinore - kategoria C- me 22-27 kredite për nivelin Bachelor, dhe 12-18 kredite për nivelin Master profesional; kurset plotësuese - kategoria D, përfshirë praktikën profesionale, kanë 18-27 kredite për nivelin Bachelor dhe 6 kredite për nivelin Master profesional, si dhe detyrat përmbyllëse kanë 5-9 kredite për nivelin Bachelor, dhe 6-12 kredite për nivelin Master profesional **[aneksi III.1.1-1.11]**. Programet ofrojnë aktivitete të ndryshme të të nxënit, të tilla si leksione, seminare, ushtrime, laborator, projekte, detyra kursi, praktika dhe tema diplome **[aneksi I.2; III.1-.1.11]**. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**.

4.2 Në programet Bachelor dhe Master profesional, orët llogariten për mësimin në klasë dhe studime individuale me studentë. Orët e praktikës profesionale konsiderohen si orë në auditor. Syllabuse përshkruajnë përmbajtjen e programeve mësimore. Ato ndërtohen në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit **[M5, aneksi I.2; III.11.1-1.11]**. Në fillim të secilës lëndë, studentët informohen për përmbajtjen e syllabuseve **[M2 ,M3 ,M5]**. Syllabuset i nënshtrohen përmirësimit të vazhdueshëm **[M5, aneksi III.7.1, III.7.2]**. Në fillim të çdo semestri, departamentet koordinojnë punën e stafit akademik dhe shpërndajnë detyrat **[M5]**. 70% e ngarkesës mësimore kryhet nga stafi akademik me kohë të plotë **[aneksi IV.2, IV.2.1-2.3]**. Programet Bachelor dhe Master profesional organizohen gjatë vitit akademik në dy semestra, ku secili përbëhet nga 15 javë. Orari i kurseve iu njoftohet studentëve në fillim të vitit akademik **[M2, M3]**. Programet e studimit publikohen në faqen e internetit të kolegjit **[aneksi XI.1]**. Studentët informohen për përmbajtjen e programeve të studimit përmes fletëpalosjeve **[aneksi XI.4.1]**. Gjatë vitit akademik 2020-2021, për informimin e studentëve, u përdor sistemi Edupage **[aneksi XI.5.1]**. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**

4.3 Zhvillimi i kurrikulës dhe përmirësimi cilësor i programeve të studimit tregohet në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2018-2024. Objektivi “Zhvillimi i Kurrikulës” fokusohet në një plan veprimi për përditësimin e kurrikulës ekzistuese, kodifikimin e tij, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kurrikulës **[Shtojca VII.1]**. Në fillim të çdo semestri departamentet analizojnë programet, stafin akademik me kohë të plotë dhe ngarkesën e tyre përkatëse **[M5]**. Rishikimi i planprogramit bëhet nga drejtuesi i lëndës **[M5]**. Janë bërë përmirësime në teknikën e mësimdhënies, në teknikën e vlerësimit dhe në përmbajtjen e lëndës. Ndryshimet lejohen në masën 20%. Për të gjitha programet literatura bazë është në gjuhën shqipe, ndërsa për literaturën e rekomanduar është në gjuhën shqipe dhe angleze. Planprogramet janë ndërtuar mbi bazën e formatit të VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018 të MAS-it (Ministria e Arsimit dhe e Sportit). Në përmbajtjen e lëndës ekziston një raport pothuajse 1:1 ndërmjet teorisë dhe praktikës. Për vitin akademik 2020–2021, bazuar në situatën e Covid-19, pjesa më e madhe e orëve laboratorike u zhvilluan online. Përveç kësaj, materialet shpjeguese, videot, simulimet virtuale, CD-të, të dhënat e pacientit virtual, materiali vizual, rastet

studimore, analizat e zgjidhjes së problemeve, laboratorët virtualë dhe testet laboratorike janë përdorur për orët laboratorike **[M2, M3, M5, M10, Aneksi I. 8]**. Ekzistojnë dy kategori praktikash: Ushtrimet dhe orët laboratorike të përfshira në përmbajtjen e çdo moduli të programit mësimor dhe praktikat profesionale **[Shtojca III.1-1.11]**. KU Logos i kushton vëmendje të madhe zhvillimit të orëve laboratorike **[M2, M3, M5, M10, Aneksi III.1-1.11]**. Në përmbajtjen e programeve të studimit dhe në planprograme jepet qartë vlerësimi i orëve laboratorike me 20 pikë **[Shtojca III.1.-1.11]**. Në kurrikul përcaktohet detyrimi i studentit në masën 75% të frekuentimit të procesit mësimor që zhvillohet në auditor (leksione, seminare, orë laborator, praktikë) **[Shtojca III.1.-1.11]**. Studentët që nuk i plotësojnë këto norma nuk hyjnë në provim **[Shtojca II.2]**. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**.

4.4 Në programet e mësimdhënies përfshihen edhe praktikat profesionale. Ato vlerësohen në programet e kategorisë D me 6 kredite **[Shtojca III.1.-1.11]**. Për programet Bachelor praktika profesionale realizohet në tremujorin e dytë të vitit të tretë dhe vlerësohet me 120 orë laboratorike. Praktikrat profesionale në programet Master Profesional zhvillohen në tremujorin e dytë të vitit akademik dhe vlerësohen përkatësisht për programin “Financë – Kontabilitet” me 120 orë, ndërsa për programin “Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë” me 150 orë, të cilat ndahen në 60 orë ushtrime dhe 90 orë në laborator. Praktika profesionale kryhet në Institucione Shtetërore dhe Kompani Biznesi me të cilat Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi **[Shtojca VIII.1-2]**. Studentët e kryejnë praktikën profesionale në laboratorë mjekësorë, spitale, në kompaninë “Helius System”, në banka dhe në Institucione Shtetërore **[M2, M3, M7]**. Praktikrat profesionale ndiqen nga stafi akademik dhe në fund studenti harton një raport që i paraqitet një komisioni të ngritur nga departamenti **[Shtojca VII.7.1-8, VIII.4]**. Studenti duhet të ketë në dosje 5 dokumente zyrtare që vërtetojnë realizimin e praktikës (dokumentin e emërimit të mbikëqyrësit, dokumentin e pranimit të studentit për praktikë, certifikatën e praktikës nga institucioni, raportin analitik të studentit, certifikatën e praktikës studentore) **[Shtojca VII.2.2; VII.7.1, VII.7.2, VII.7.4, VII.7.5, VII.7.7, VII.7.8]**. Për vitin akademik 2020-2021, si pasojë e situatës së shkaktuar nga COVID-19, praktika profesionale zhvillohet online **[Shtojca Nr. I.7, VII.7.1]**. Në këtë proces fokus i është kushtuar raportit të praktikës profesionale, organizimit të punimeve laboratorike, krijimit të modeleve, simulimit (video, audio), krijimit të provave dhe analizave për rastet studimore. Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e praktikës profesionale online shprehen në udhëzimet e përgatitura nga Senati Akademik **[Aneksi I.8, VII.7.3, II.26.4, VII.7.3]**. Puna laboratorike dhe praktikrat profesionale kryhen në grupe me jo më shumë se 15 studentë **[M5]**. Për zhvillimin e orëve laboratorike për programet Bachelor dhe Master Profesional, Institucioni ka vënë në dispozicion 11 laboratorë (një laborator për pedagogjinë, laboratorin e gjuhës greke, laboratorë teknikë, 3 laboratorë të informatikës dhe 1 laborator për përpunimin e të dhënave ekonomike) **[Shtojca II. .26.3]**. Për vitin akademik 2021-2022 janë bërë përpjekje për përmirësimin e laboratorëve dhe ngritjen e laboratorëve të rinj si Laboratori i Gjenetikës që do t'i shërbejë programeve Bachelor dhe Master Profesional për “Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësor” **[Shtojca II.26.4]**. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**.

4.5 Institucioni ka angazhuar një staf akademik me përvojë dhe ekspertizë në procesin e zhvillimit të kurrikulave **[Shtojca IV.8-9]**. Drejtuesit e kursit kanë minimalisht gradën Doktor për Programet Master Profesional. Stafi mësimor bazuar në prioritetin nr. 2, objektivin nr.1 të Strategjisë së Zhvillimit 2018-2024 **[Shtojca II.5.1]** përmirëson programet mësimore në fillim të çdo viti akademik **[M5]**. Kërkesa për përmirësim bazohet në ndryshimet në kuadrin ligjor

të kërkuar nga MAS-i (Ministria e Arsimit dhe e Sportit), nga zhvillimet teknologjike, sugjerimet e kompanive të biznesit dhe nga rezultatet e përpunuara statistikore të pyetësorëve të studentëve **[Shtojca III.7.2-7.3]**. Për vitin 2019-2020, të gjitha programet janë përmirësuar, gjë që ka sjellë një përmirësim të orëve mësimore me 30%, ndarje të drejtë sipas përqindjes së lëndëve në kategori, shpërndarje më të drejtë të krediteve, përmirësim të ngarkesës mësimore të stafit akademik krahasuar me vitet e mëparshme dhe një përmirësim në format dhe teknikat e mësimdhënies **[Shtojca II.26.3]**. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**.

4.6 Në mbështetje të programeve mësimore, Institucioni ka vënë në dispozicion dy biblioteka, përkatësisht “Logos” me 18 vende me akses në kompjuter dhe akses të pakufizuar në internet dhe 40 vende të tjera studimi **[Shtojca XI.7.]** dhe bibliotekën “Ringjallja” e vendosur në kampusin Shën Vlash, Durrës, e cila ka pesë vende me akses në kompjuter dhe 20 vende të tjera studimi **[Shtojca XI.7]**. Kërkesa për libra vjen nga stafi akademik i çdo departamenti dhe pasurimi i bibliotekës bëhet përmes blerjeve dhe donacioneve **[Vizitë informuese, M5, M10]**. Vitet 2019 dhe 2020 kanë sjellë një numër në rritje të librave në gjuhën shqipe **[Shtojca XI.7,7.1-7.6]**. KU Logos ofron akses në literaturën online të bibliotekës ndërkombëtare Questia Online Library: [www.questia.com](http://www.questia.com) **[Aneksi XI.7 - XI.7.1]**. Në janar të vitit 2021, u bë një abonim digjital njëvjeçar në revistën shqiptare MONITOR **[Shtojca XI.7.2]**. Biblioteka ka edhe materiale të tjera përveç librave (Cd, DVD, Audio, Video) në shqip 124 copë, në gjuhën greke 148 copë dhe në anglisht ose gjuhë të tjera 206 copë **[Shtojca XI.7.2, Vizitë Informuese]**. Janë bërë përpjekje për të përkthyer literaturë nga greqishtja dhe anglishtja në gjuhën shqipe për fushat ku ka vështirësi në gjetjen e literaturës në gjuhën shqipe **[M10]**. ***Si rrjedhim, ekipi i vlerësimit ka konstatuar se institucioni ka adresuar rekomandimin në lidhje me këtë fushë të bërë në vlerësimin e mëparshëm. [Kapitulli I, Standardi II.1].***

“Ringjallja” me vendndodhje në Shën Vlash. Institucioni mbështet veprimtarinë e bibliotekës e cila funksionon në bazë të një rregulloreje të miratuar **[Shtojca II.23.2]**. Biblioteka nr.1 ka 18 vende me akses kompjuteri dhe 40 vende studimi ndërsa biblioteka nr.2 ka pesë vende me akses kompjuteri dhe 20 vende studimi. Bibliotekat kanë një mjedis standard të integruar për këtë funksion. **[Vizita]**. Studentët kanë kartën e tyre të regjistrimit e cila menaxhohet nga sistemi i bibliotekës **[Vizita]**. Pasurimi i bibliotekës arrihet nëpërmjet blerjeve sipas kërkesave të përcaktuara nga fakultetet **[Shtojca XI.7.4, XI.7.5, XI.7.6]** dhe donacioneve që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me organet shtetërore si Parlamenti shqiptar, Institucioni i Mbikëqyrjes dhe bashkëpunimi me fondacionin “Logos” **[Shtojca VIII.4, VIII.5, VIII.6]**. Në vitin 2019 bibliotekat janë pasuruar me gjithsej 924 libra ku 40% janë libra në gjuhën shqipe (19.6% janë blerë), për vitin 2020 janë shtuar 1302 libra ku 17.58% janë në gjuhën shqipe dhe 93.5% prej tyre janë donacione. Aktualisht biblioteka ka një fond prej 23604 librash ku literatura në gjuhën shqipe zë 6,36%, dhe literatura në gjuhën angleze mbizotëron me 49,57%. Fondi i bibliotekës përdor programin e katalogimit elektronik PLEIADES bazuar në standardin MARC 21 dhe katalogun elektronik [http: lib-orthodoxalbania.org](http://lib-orthodoxalbania.org) mundëson gjetjen e informacionit të disponueshëm nga biblioteka **[Vizita]**. KU Logos ofron akses në literaturën online të bibliotekës ndërkombëtare Questia Online Library dhe bashkëpunon me Universitetin e Pireut nëpërmjet aksesit online në bibliotekën e këtij të fundit **[Shtojca XI.7.1]**. Bibliotekat ofrojnë gjithsej 180 tituj periodikë **[Shtojca XI.7.7]**. Bibliotekat ofrojnë gjithsej 478 materiale si CD, DVD, Audio, Video ku materiali në gjuhën shqipe është 25.9%. Bazuar në Rregulloren e Brendshme për Covid-19, studentëve nuk iu ofrohet asnjë material i printuar. Kërkesat për material nga studentët dhe stafi akademik plotësohen nëpërmjet skanimit dhe dërgimit të materialeve në adresat e tyre të emailit ose duke përdorur portalet si Edu Page dhe Microsoft Teams (office 365) **[Shtojca XI.7, XI.7, XI.7.2, XI.7.3]**. **[Kapitulli I, Standardi III.5]**.

5.13 Krahas procesit të mentorimit, stafi akademik ofron ndihmë edhe nëpërmjet konsultimeve dhe sqarimeve që bëhen gjithmonë kur studenti përballet me vështirësi **[M2, M3, M5]**. Stafi akademik asiston në praktikat profesionale që studenti ndjek dhe vlerëson punën e bërë gjatë periudhës së praktikës. **[Shtojca nr II.2, II.3.1, II.3.2, II.3.3, II.3.4, II.3.4.1, II.3.5, II.3.6, II.3.7]**. Përgatitja e temës së diplomës nga studentët që kanë mesatare të lartë sipas miratimit të dhënë nga çdo departament mbikëqyret nga personeli akademik **[Shtojca II.3.7]**. Pjesëmarrja në seminare dhe trajnime të hapura kontribuon gjithashtu në formimin e tyre **[Shtojca V.4.1.4, V.5.2.1-5.3.1]**. Sekretariatet mësimore japin informacion për studentët në lidhje me detyrimet e tyre dhe mbështesin studentët gjatë vitit akademik **[Shtojca II.2, II.21]**. Përgjegjësi i Departamentit monitoron ecurinë e studentëve, kalueshmërinë, vijueshmërinë, pjesëmarrjen në provime dhe të dhënat përpunohen statistikisht në raportet vjetore të shoqëruara me rekomandime për përmirësime **[Shtojca II.26.3, II.26.2, II.26.1]**. Bibliotekat ndihmojnë në sigurimin e literaturës që secili student paraqet në përgatitjen e tyre **[M2, M3, M6]**. Institucioni përdor politika për mbështetjen e studentëve dhe informimin e tyre për studimet e ciklit të dytë **[Shtojca II.5.1]**. Institucioni ka shfaqur përpjekje për hapjen e programeve të reja në ciklin e dytë, megjithëse ende nuk ka marrë miratimin nga MAS. **[Kapitulli I, Standardi III.6]**.

5.14 Studentët janë aktivë dhe marrin pjesë në vendimmarrje **[Shtojca II.1]**. Përfaqësimi i tyre është i dukshëm në të gjitha Komisionet e Kolegjit. Studentët kanë një Këshill Studentor që ka anëtarësim në të gjitha departamentet e Institucionit. Studentët marrin pjesë në përmirësimin e kurrikulave duke dhënë komentet e tyre gjatë plotësimit të pyetësorëve

**[Shtojca VI.15]**, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në komisionet e kolegjit **[Shtojca III.7.5, III.7.6]**. Zyra e Këshillit Studentor ndodhet në katin e 7-të në godinën nr.1 dhe është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për të organizuar aktivitetet e tyre **[Vizita]**. Institucioni mbështet financiarisht aktivitetet sociale dhe kulturore të studentëve **[Shtojca 26.3, II.26.2, II.26.1]**. Mendimi i tyre pasqyrohet në programet e përmirësuar, në teknikat e mësimdhënies, në ndryshimin e ngarkesës së studentit në javë në kurrikulat **[Shtojca II.26.1-26.6]**, në oraret e mësimdhënies **[Shtojca III.7.5-7.6]**, në përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe pasurimin me pajisje laboratorike **[Shtojca VI.9]**. **[Kapitulli I, Standardi III.6, Standardi III.8]**.

5.15 Studentët kanë aktivitete të ndryshme sociale dhe kulturore. Ata kanë konferencën e tyre studentore të organizuar çdo vit **[Shtojca V.4.1.3, V.4.1.4]**. Gjatë këtyre konferencave ata prezantojnë punimet e tyre më të mira në projekte apo teza diplome; vetëm për këtë vit pandemik, kjo konferencë është anuluar. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me Këshillin Studentor për organizimin e aktiviteteve kulturore. Institucioni zbaton politikat që lidhen me ofrimin e praktikës studentore të nisur në vitin 2020 **[Shtojca VII.8.3]** dhe ka një infermieri që ndodhet në katin e 5-të të godinës kryesore **[Vizita]**. Aktivitetet e studentëve janë parashikuar edhe në planet financiare të Institucionit dhe janë pasqyruar në bilancin e fundit të vitit financiar. Për periudhën 2017-2018 janë shpenzuar 4666 euro për aktivitetet e Këshillit Studentor ndërsa 1000 euro janë ndarë për pjesëmarrjen në javën e turizmit dhe mjedisit **[Shtojca II.26.1-26.3]**. Për vitin 2018-2019 dhe 2019-2020 shpenzimet janë pasqyruar në aktivitetet e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, e cila vetëm për vitin 2019-2020 ka shpenzuar 1,079,097 ALL ose ka shfrytëzuar 28.4% të fondit të dhënë për studentët **[Shtojca II.26.1-26.3]**. Në vitin 2020-2021, aktivitetet janë reduktuar shumë si pasojë e Covid-19 dhe kufizimeve të vendosura nga pandemia. Nga takimet me studentët u tërhoq vëmendja për ndihmën që ata dhanë për familjet e prekura nga tërmeti në Durrës **[M2, M3, M5]**. **[Kapitulli I, Standardi III.7]**.

5.16 Të dhënat e punësimit monitorohen nga Zyra e Çështjeve të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me departamentet dhe pasqyrohen në raportet vjetore **[Shtojca II.26.1-26.6]**. Strategjia e Zhvillimit 2018-2024 **[Shtojcall.5.1]** dhe aktivitetet e departamenteve i kushtohet trajnimit të studentëve në përputhje me tregun e punës **[Shtojca II.26.4, II.26.5, II.26.6-26.6]**. Për vitin 2018-2019, programi Master Profesional “Teknik i Lartë në Laboratorë Mjekësorë” shfaq normën më të lartë të punësimit (36%), ndërsa për të njëjtin cikël për programin “Financë – Kontabilitet” nuk ka të dhëna të mbledhura për normat e punësimit të studentëve. Sa i përket ciklit të parë, programi “Menaxhimi i Turizmit” shfaq të dhëna statistikore pozitive (75%), megjithatë, numri i studentëve për këtë program është i ulët (4 studentë), gjë që krijon vështirësi në përcaktimin e shkallës së suksesit të programit. Për vitin 2019-2020 ka një rritje të numrit të studentëve të punësuar në programin “Teknik i Lartë në Laboratorë Mjekësorë” për të dy ciklet përkatësisht 57,1% dhe 67%, ndjekur nga programi i ciklit të dytë “Financë – Kontabilitet” me 60%. Për programet e ciklit të parë, programi Bachelor në Financë-Kontabilitet (37.5%) dhe Bachelor në Informatikë të Aplikuar (30%) shfaqin norma të përmirësuar punësimi **[Shtojca II.26.3, II.26.2, II.26.1]**. **[Kapitulli I, Standardi 111.9]**.

## **Gjetjet**

### **Praktikat e mira**

Ekipi i vlerësimit nuk identifikoi tipare të praktikave të mira.

### **Dobësitë**

Ekipi i vlerësimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Numri i ulët i studentëve të regjistruar për herë të parë në disa programe Bachelor (*paragrafi 5.3*). **[Kapitulli I Standardi III.1]**.
- Mungesa e raporteve vjetore të përgatitura nga Zyra për Çështje Studentore dhe Këshillimit për Karrierë (*paragrafi 5.6*), **[Kapitulli I, Standardi III.2]**.

### **Rekomandime**

- Promovoni përdorimin e instrumenteve të marketingut, kërkimit të tregut dhe informacionit publik me qëllim arritjen dhe ruajtjen e numrit të studentëve të regjistruar për çdo program studimi siç deklarohet nga Institucioni gjatë fazës së licencimit të programit të studimit. (*paragrafi 5.3*), **[Kapitulli I Standardi III.1]**.
- Fuqizoni punën e Zyrës së Çështjeve të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës në drejtim të informimit të publikut, gjurmimit të punësimit dhe karrierës së studentëve, mbledhjes, përpunimit të të dhënave dhe përgatitjes së analizave statistikore për përparimin e studentëve dhe problemet e tyre të reflektuara gjatë vitit akademik. (*paragrafi 5.6*), **[Kapitulli I]**.

### **Konfirmim i veprimeve që po ndërmerren**

Ekipi i vlerësimit nuk identifikoi konfirmim.

### **Vlerësimi**

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **të përmbushura kryesisht**.

## **Lista evidentuese**

### **Takimet**

- M2 Takim me Rektorin
- M3 Takim me studentë të ciklit të parë
- M4 Takim me studentë të ciklit të dytë
- M5 Takim me stafin mësimdhënës
- M6 Takimi me stafin mbështetës
- M7 Takim me partnerë të jashtëm dhe alumni
- M10 Takim me dekanët e fakultetit dhe shefat e departamenteve
- M11 Takimi me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- M12 Takimi me Menaxherët e Lartë
- M13 Takimi me Ekipin e Vetëvlerësimit
- Vizita Vizita në ambiente

### **Shtojca O – Informacion mbi Historikun**

1. Urdhri Nr. 1055 Për Licencimin e Logos SHLP dhe Urdhri Nr. 386.
2. Urdhri Nr. 1 Për hapjen e një programi të ri studimi.
3. Urdhri Nr. 481 Për lejimin e fillimit/zbatimit të aktivitetit akademik.
4. Urdhri Nr. 282 Për akreditimin e programeve institucionale dhe studimore.
5. Vendimi Nr. 338 i Këshillit të Akreditimit.
6. Urdhri Nr. 335 Për hapjen e programeve pasuniversitare (Master).
7. Urdhri Nr. 342 Për akreditimin me kusht të programit Master Profesional.
8. Urdhri Nr. 606 Për plotësimin e kushteve për akreditimin e programit të studimit.
9. Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 70-1, datë 2.11.2015 Për akreditimin e programit të ciklit të dytë (Master profesional në TALM).
- 9.1 Urdhri Nr. 93 datë 06.03.2017 Miratimi i Statutit të Kolegjit Universitar LOGOS.
10. Urdhri Nr. 408 Për hapjen e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.
11. Urdhri Nr. 433 Për hapjen e programit të studimeve Bachelor në Gjuhën dhe Civilizimin Grek.
12. Urdhri Nr. 192 Për hapjen e programit të studimeve Bachelor në Theologji dhe Shkenca Religjioze.
13. Urdhri Nr. 432 Për hapjen e programit të studimit Bachelor në Arsimin Parashkollor.
14. Urdhri Nr.405 Për hapjen e programit të studimit profesional në Agro-Biznes.
15. Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 95, datë 20.10.2017 “Vendim i Trupit Akreditues për Akreditimin Institucional periodik”.
16. Përbërja e ekipit të brendshëm të vetëvlerësimit.
17. Urdhri MASH Nr. 350, dt. 16.11.2000 “Për dhënien e lejes për institucionin arsimor jopublik”.
18. Formulari i aplikimit të Akreditimit Periodik Institucional “Kolegji Universitar Logos”.
19. Tabela përmbledhëse që tregon të dhënat për licencimin, akreditimin dhe statusin aktual të programeve të studimit.
20. Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr.524, datë 18.07.2013 “Programet e Studimeve Pasuniversitare”

## **Shtojca I – Baza ligjore e Kolegjit Universitar Logos. Vendimet e Senatit Akademik dhe Rektoratit për krijimin e strukturave përkatëse universitare.**

- 1.1. Dokumentet e Kolegjit Universitar LOGOS, SA (Agjenda, Vendimet) — (d.m.th. Mbledhja e SA e datës 13.02.2019.
- 1.2. Të dhënat që tregojnë procedurat sipas të cilave janë bërë ndryshime në kurrikulë.
- 1.3. Marrëveshjet ndërmjet KU “LOGOS” dhe MAS (datë 01.07.2019) për përcaktimin e personelit akademik me kohë të plotë që i përket departamentit.
- 1.4. Procesverbalet e Rektoratit të Kolegjit Universitar LOGOS (Agjenda, Njoftimet).
- 1.5. Të dhëna për riorganizimin e departamenteve të Kolegjit Universitar LOGOS.
- 1.6. Vendimi i Rektoratit Nr. 3, datë 14.02.2020 Për organizimin e ditëve informative me funksion këshillimin e karrierës për të angazhuar studentë.
- 1.7. Urdhri i Rektoratit Nr. 10, datë 22.03.2020 Për përdorimin e platformës digjitale për mësimin në distancë.
- 1.8. Udhëzimi i SA. Nr 4, datë 1 1.05.2020 Për politikën e vlerësimit në distancë në Kolegjin Universitar LOGOS.
- 1.9. Vendim i SA Nr. 18, datë 28.09.2020 për miratimin e përbërjes së komisioneve.
- 1.10. Vendim Senati, Nr. 19, datë 28.09.2020 për miratimin e përbërjes së Këshillit të Etikës së KU LOGOS.
- 1.11. Dokumentimi i procedurave për ndryshimin e strukturës nga Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë në Gjuhë dhe Civilizim Grek.
- 1.12. Vendim i Senatit Nr. 23, datë 30.10.2020 Për përbërjen e Senatit Akademik.
- 1.13. Vendim Senatit Nr. 3, datë 15.12.2020 Miratimi i kalendarit akademik 2020-2021.
- 1.14. Standardet Shtetërore të Cilësisë.
- 1.15. Organizimi i Kolegjit Universitar LOGOS (organet drejtuese).

## **Shtojca II – Statuti, Rregulloret dhe Raportet e Kolegjit Universitar Logos**

1. Statuti i Kolegjit Universitar Logos.
2. Rregullorja e përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS.
3. Rregulloret e Fakultetit dhe Departamentit të Kolegjit Universitar LOGOS.
  - 3.1 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.
  - 3.2 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik.
  - 3.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara.
  - 3.4 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit të Turizmit.
  - 3.5 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.
  - 3.6 Rregullorja e Departamentit Financë-Kontabilitet.
  - 3.7 Rregullorja e Departamentit të Agrobiznesit.
  - 3.8 Rregullorja e Departamentit të Shkencave Mjekësore.
  - 3.9 Rregullorja e Departamentit të Informatikës së Aplikuar dhe Statistikave.
4. Rregullimi i programeve të studimit të parë (Bachelor) dhe të dytë (Master) të Kolegjit Universitar LOGOS.
  - 4.1 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Financë – Kontabilitet.
  - 4.2 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Teknika të Avancuara në Laboratorët Mjekësorë.
  - 4.3 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi.
  - 4.4 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkenca Religjioze.
  - 4.5 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Informatikë të Aplikuar.
  - 4.6 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë.
  - 4.7 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhën dhe Civilizimin Grek.

- 4.8 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Arsimin Parashkollor.
- 4.9 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi.
- 4.10 Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet.
- 5. Planet strategjike të institucionit, të fakulteteve, departamenteve dhe të programeve të studimit.
- 5.1 Plani Strategjik i Kolegjit Universitar LOGOS, 2018-2024 (versioni Shqip).
- 5.1.1 Plani Strategjik i Kolegjit Universitar LOGOS, 2018-2024 (versioni në anglisht).
- 5.2 Plani Strategjik i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, 2020-2025.
- 5.3 Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor & Master Profesional në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë 2018.
- 5.4 Plani Zhvillimor i Fakultetit Ekonomik lidhur me përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit 2017.
- 5.5 Strategjia zhvillimore afatshkurtër dhe afatmesme e Departamentit Financë-Kontabilitet 2017-2021.
- 6. Informacion mbi Politikat për aspekte të ndryshme të veprimtarisë në Kolegjin Universitar LOGOS.
- 6.1 Politika dhe procedura e burimeve njerëzore të Kolegjit Universitar LOGOS.
- 7. Organigrami i Kolegjit Universitar LOGOS.
- 8. Misioni i Kolegjit Universitar LOGOS.
- 9. Rregullorja e Senatit Akademik të Kolegjit Universitar LOGOS.
- 10. Rregullorja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Standardeve të Cilësisë në lidhje me Programet e Studimit dhe Institucionin.
- 11. Rregullorja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Funkcionimit Institucional dhe Trupës studentore.
- 12. Rregullorja e Këshillit të Etikës.
- 13. Kodi i Etikës.
- 14. Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë.
- 15. Rregullorja e Transferimit të Studentëve.
- 16. Rregullorja e Qendrës së Zhvillimit dhe Kërkimit Shkencor.
- 17. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
- 18. Rregullore e brendshme për sigurinë dhe mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.
- 19. Rregullore për provimet online, 2020-2021.
- 20. Rregullorja e Arkivit - Zyra e Protokollit.
- 21. Rregulloret e Zyrës së Regjistrimit.
- 22. Rregullorja e Zyrës së Financës.
- 23.1. Plani Strategjik i Bibliotekës së Kolegjit Universitar LOGOS (2019-2023).
- 23.2. Rregullore e Bibliotekës së Kolegjit Universitar LOGOS.
- 24. Rregullore për funksionimin e Zyrës për Çështjet Studentore dhe Këshillim të Karrierës.
- 25. Statuti i Këshillit Studentor.
- 25.1 Rregullorja e Këshillit Studentor.
- 26. Raport vjetor, institucional dhe i departamenteve i Kolegjit Universitar LOGOS.
- 26.1 Raport vjetor i veprimtarisë së LOGOS për vitin akademik 2017-2018.
- 26.2 Raport vjetor i veprimtarisë së LOGOS për vitin akademik 2018-2019.
- 26.3 Raport vjetor i veprimtarisë së LOGOS për vitin akademik 2019-2020.
- 26.4 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Mjekësore 2019-2020.
- 26.5 Raport Vjetor i Departamentit të Gjuhës dhe Civilizimit Grek 2019-2020.
- 26.6 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2018-2019.

### **Shtojca III – Programet e studimit universitar dhe pasuniversitar të Kolegjit Universitar Logos**

0. Përmbledhje e Programeve të Studimit të ofruara të Kolegjit Universitar LOGOS.
1. Kurrikula dhe planprogrami për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë.
  - 1.1 Kurrikula dhe planprogramet e programit të studimit Master në Financë - Kontabilitet 2019-2020.
  - 1.2 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Master në Teknika të Avancuara në Laboratorin Mjekësor 2018-2019.
  - 1.3 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi 2017- 2018, 2018-2019, 2019-2020.
  - 1.4 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020.
  - 1.5 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet 2019-2020.
  - 1.6 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Informatikë të Aplikuar 2017-2018. 2018-2019, 2019-2020.
  - 1.7 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Teknika të Avancuara në Laboratorin Mjekësor 2018-2019, 2019-2020.
  - 1.8 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Theologji dhe Shkenca Religjioze 2019-2020, 2020-2021.
  - 1.9 Kurrikula dhe planprogramet për programin e studimit Bachelor në Gjuhën dhe Civilizimin Grek 2019-2020, 2020-2021.
  - 1.10 Kurrikula dhe Planprogramet për Programin e Studimit Bachelor në Arsimin Parashkollor 2020- 2021
  - 1.11 Kurrikula dhe Planprogramet për Programin e Studimeve Profesionale në “Agrobiznes” me profil “Marketingu i produkteve bujqësore” dhe “Menaxhimi i fermave bujqësore”.
2. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institutet e Arsimit të Lartë”.
3. Kuadri i Kualifikimeve të Shqipërisë. Ligji 10247 datë 04.03.2010.
4. Aplikim për hapjen e Programeve të reja të Studimit 2020
5. Analiza e tregut të punës për Programet e reja të Studimit për të cilat institucioni ka aplikuar.
  - 5.1 Një shembull i modelit të analizës së tregut për programet e studimit Bachelor HTML, 2018.
6. Raport shpjegues për Programet e Edukimit në Vazhdim nga Senati Akademik datë 04.02.2020.
  - 7.1. Vendim i Departamentit të Theologjisë Sociale dhe Studimeve Religjioze, Nr.1, datë 26.02.2019, Për ndryshime (në masën 20%) të programit të studimit.
  - 7.2 Raport i bazuar në dëshmi për përmirësimin e ndryshimeve të bëra në Programin e Studimit “Arsimi Parashkollor”.
  - 7.3 Raport për ndryshimet e bëra në kurrikulën dhe planprogramin e programit të studimit Informatikë e Aplikuar datë 13.3.2019.
  - 7.4. Mbledhja e stafit akademik të Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë për bashkërendimin e punës për integrimin e temave në lëndë/module, datë 12.01.2021.
  - 7.5 Takimi i Studentëve me stafin e Departamentit me synim diskutimin e koherencës së programeve të studimit.
  - 7.6 Miratimi i sugjerimit të përfaqësimit të studentëve në Senatin Akademik për përmirësimin e kurrikulës (Për praktikë laboratorike shtesë në programin e studimit



Bachelor në Informatikë të Aplikuar). Plani i ndryshuar 2019-2020; në përmbushje të kërkesës).

8. Dëshmi që tregojnë lirinë akademike.

#### **Shtojca IV Dokumentet që lidhen me veprimtarinë e personelit në fakultete dhe departamente.**

1. Udhëzime MAS për "Ngarkesën Mësimore" Nr 29 datë 10.09.2018.
2. "Ngarkesa Mësimore" (përmbledhje) e stafit Akademik të ndarë sipas kategorive gjatë viteve akademike 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020.
- 2.1 "Ngarkesa Mësimore" e Departamentit të Menaxhimit të Turizmit Viti akademik 2018-2019.
- 2.2 "Ngarkesa Mësimore" e Departamentit të Menaxhim Biznesit Viti akademik 2018-2019.
- 2.3 "Ngarkesa Mësimore" Programi i Studimit Bachelor në Programin e Mësuesit të Arsimit Parashkollor 2020-2021.
- 2.4 Shpërndarja e Personelit Akademik në Kolegjin Universitar LOGOS.
3. Kontratat individuale të punës për personelin ndihmës akademik me profil administrativ dhe kontratë pune individuale për personelin administrativ.
- 3.1 Kontratë pune individuale për personelin akademik të Kolegjit Universitar LOGOS.
4. Dokumentet e paketës së rekrutimit dhe procesit të përzgjedhjes për Stafin Akademik me kohë të plotë (Shembull; Departamenti i Agrobiznesit).
- 4.1 Dokumentet e Paketës së rekrutimit dhe i procesit të përzgjedhjes për FSH H KGJ).
5. Dëshmi që tregojnë kohë të plotë dhe të pjeshme.
6. Statistikat që tregojnë kualifikimet e stafit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme) (shembull i personelit akademik 2018-2019).
7. Informacion në lidhje me zhvillimin, integrimin dhe pjesëmarrjen e stafit të Kolegjit Universitar Logos.
- 7.1 Informacion në lidhje me mobilitetin e stafit në Kolegjin Universitar Logos.
8. Ekspertiza e pedagogëve të Kolegjit Universitar Logos.
9. Kualifikimet e Stafit të Kolegjit Universitar Logos.
10. Informacion në lidhje me përfshirjen e stafit të Kolegjit Universitar LOGOS në ngjarje sociale.
11. Përfshirja e stafit akademik në promovimin e programeve të Kolegjit Universitar Logos për studentët e shkollave të mesme (Fakulteti Ekonomik).
12. Shembull i mbledhjes së Departamentit (Shembull f-Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës datë 12.02.2019).
13. Paketa e Vlerësimit për Stafin Akademik me kohë të plotë në Kolegjin Universitar Logos (shembull, departamenti i Informatikës së Aplikuar; Shkenca Mjekësore).
14. Këshilli i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Sociale: Veprimtaria.
15. Dëshmi në lidhje me dokumentet që tregojnë punën e Këshillit të Etikës.
16. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme Akademike të Kolegjit Universitar LOGOS.
17. Mbledhja e Asamblesë së Stafit Akademik; Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.
18. Letër e Rektorit si kujtesë për zbatimin e hierarkisë dhe për komunikim.
19. Informacion në lidhje me paraqitjet televizive të stafit akademik.
20. Pamje nga veprimtaria e Gjuhës Ndërkombëtare Greke.
21. Vendim Departamenti i Theologjisë Sociale dhe Studimeve Religjioze Nr. 4, dt 16.4.2019 - Për Shkollën Verore.
22. Të dhëna përmbledhëse të personelit akademik sipas programeve të studimit dhe kualifikimeve.

## Shtojca V – Kërkimi shkencor

- 0 Raporte mbi kërkimin shkencor.
- 1.1 Raporti i aktiviteteve shkencore Kolegji Universitar LOGOS 2019-2020.
- 1.2 Raporti i aktiviteteve shkencore Kolegji Universitar LOGOS 2018-2019.
- 1.3 Raport kërkimor shkencor për Fakultetin Ekonomik 2016-2017, 2017-2018.
- 1.4.1. Aktivitetet kërkimore-shkencore të Fakultetit Ekonomik 2018-2019.
- 1.4.2. Aktivitetet kërkimore-shkencore të Fakultetit Ekonomik 2019-2020.
- 1.5 Planifikimi për punën kërkimore-shkencore të Departamentit të Theologjisë Sociale dhe Kulturës.
- 1.6 Raporti i Grupit Kërkimor; Departamenti i Shkencave Mjekësore 2019-2020.
- 1.7 Plani Strategjik i Qendrës Kërkimore Shkencore 2017-2024.
- 2. Grupet e kërkimit shkencor sipas nivelit të departamentit.
- 2.1 Grupet kërkimore dhe mësimore; Departamenti i Informatikës së Aplikuar dhe Statistikave.
- 2.2 Grupet kërkimore dhe mësimore; Departamenti i Shkencave Mjekësore.
- 2.3 Grupet kërkimore dhe mësimore; Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë.
- 2.4 Grupet kërkimore dhe mësimore; Departamenti i Financës-Kontabilitetit.
- 3. Kërkimi shkencor; Baza e të dhënave.
- 3.1 Baza e të dhënave të aktivitetit kërkimor-shkencor; Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek 2018-2019, 2019-2020.
- 3.2 Baza e të dhënave të aktivitetit kërkimor-shkencor; Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës.
- 3.3 Objektivat individuale të kërkimit; Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë.
- 3.4 Aktiviteti shkencor; Departamenti i Teknikave të Avancuara në Laboratorin Mjekësor 2016-2017, 2017-2018.
- 3.5 Raporti i Qendrës Kërkimore Shkencore; 2018-2019.
- 4.1 Konferenca e Dytë Ndërkombëtare për Shkenca të Aplikuara dhe Ekonomi.
- 4.1.2 Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për Shkenca Humane, Shkenca Sociale dhe Shkenca të Aplikuara.
- 4.1.3 Konferenca e Dytë Studentore në Shkenca të Aplikuara dhe Ekonomi.
- 4.1.4. Konferenca e Tretë Studentore në Shkenca Humane, Shkenca Sociale dhe Shkenca të Aplikuara.
- 4.1.5 Konferenca Ndërkombëtare "Psikologjia e Aplikuar dhe Shkenca Edukative".
- 5. Veprimtari zhvillimore.
- 5.1 Lidhje përkatëse për aktivitetet si më poshtë: Tryezë e rrumbullakët, Simpozium, Ekspozitë.
- 5.2.1 leksione të hapura 2019-2020.
- 5.2.2 leksione të hapura 2018-2019.
- 5.3. Seminar - Aplikimi i teknologjisë moderne në mjekësinë laboratorike.
- 5.3.2 Seminar COST Action në "Qasjet gjuhësore dhe metodologjike ndaj zhvendosjes njerëzore".
- 5.4.1 Trajnimet 2019-2020.
- 5.4.2 Trajnimet 2018-2019.
- 6. Botimet e Kolegjit Universitar LOGOS.
- 6.1 Revista shkencore LOGOS, Nr. 4 & 5.
- 6.2 Revista e Theologjisë dhe Kulturës , Vëll. 1.1 dhe 1.2.
- 6.3 Revista Studentore LOGOS, Nr. 1
- 6.3.1 Revista Studentore LOGOS, Nr. 2.
- 6.4 Revista Studentore "Fjala", kopertina e botimit të ri.

- 6.5 Libri i abstrakteve; Konferenca e Dytë Ndërkombëtare për Shkenca të Aplikuara dhe Ekonomi.
- 6.5.1 Libri i punimeve; Konferenca e Dytë Ndërkombëtare për Shkenca të Aplikuara dhe Ekonomi.
- 6.6.1 Libri i abstrakteve; Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për Shkenca Humane, Shkenca Sociale dhe Shkenca të Aplikuara.
- 6.6.2 Libri i punimeve; Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për Shkenca Humane, Shkenca Sociale dhe Shkenca të Aplikuara.
- 6.7 Manuali “Kërpudhat helmuese dhe të ngrënshme në Shqipëri” botuar nga Kolegji Universitar LOGOS.
- 6.8 Vendim i Departamentit të Theologjisë Sociale dhe Kulturës: Për fillimin e një reviste akademike.
- 6.9. Kriteret e botimit në Revistën Shkencore LOGOS.
- 6.9.2 Udhëzime për pjesëmarrje në konferencë dhe botim në librin e punimeve.
- 6.10 Publikimet e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës 2019-2020.
- 6.11. Libra Akademikë të Kolegjit Universitar LOGOS.
- 6.12.1 Botimi në gazetë i një studimi nga stafi akademik KG.
- 6.12.2 Botimi nga Kolegji Universitar Logos/Studim me autor personeli akademik K.G.
- 7. Projektet kombëtare dhe ndërkombëtare
- 7.1 Projekti i Theologjisë.
- 7.2 Projekti Eko Destinacion.
- 7.3 Projektet Erasmus.
- 7.3.1 Mobiliteti i studentëve.
- 7.3.2 Mobiliteti i stafit.

## **Shtojca VI – Strukturat e Sigurimit të cilësisë.**

- 0. Strukturat e Sigurimit të Cilësisë.
- 1. Politika e Sigurimit të Cilësisë.
- 2. Veprimtaria e Komisionit për Sigurimin e Cilësisë.
- 2.1. Agjenda e takimit të fundit.
- 3. Formularët e vlerësimit nga NJSBC 2018-2019.
- 4. Formulari i vlerësimit përmbledhës për stafin akademik (Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit).
- 5. Raport nga NJSBC për regjistrin e vlerësimit të studentëve dhe formati i provimit 2017-2018.
- 6. Vendime për përbërjen e NJSBC (2011, 2018, 2020) të Kolegjit Universitar LOGOS.
- 7. Metodologjia e vlerësimit - Fakulteti Ekonomik.
- 8. Njoftim për vlerësimin e personelit akademik.
- 9. NJSBC - Rezultatet e pyetësorit.
- 10. Procesverbali i NJSBC për Menaxhim-Biznesin fq.18.
- 11. Procesverbal për hartimin e pyetësorit 2018, datë 06.06.2018.
- 12. Procesverbali për regjistrin e vlerësimit të studentëve, provimin, vlerësimin e leksioneve në klasë TLLM, më 2017-2018.
- 13. Raporti i NJSBC për aktivitetet; Vitet 2017-2018 & Plani i programit NJSBC (vitet akademike 2018-2019).
- 14. Vlerësimi i Leksionit në klasë; Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës.
- 15. Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësor, semestri 1 2019-2020.
- 16. Raport nga NJSBC, datë 22.07.2019.

## **Shtojca – VII – Zyra e Çështjeve Studentore dhe e Karrierës dhe Praktika Profesionale e Studentëve**

1. Pjesë nga plani strategjik 2018-2024 kushtuar studentëve.
- 2.1. Lista e aplikantëve për programin e studimit II FSHDPAK (2020-2021).
- 2.2. Pranimi i studentëve të rinj, aktivitete të realizuara në këtë kuadër. Prezantimi “Pritja e Studentëve Viti I II,” Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës.
- 2.3. Vendim për Krijimin e Komisionit të Pranimeve Ndër-departamente.
- 2.4. Procedura në lidhje me transferimin e studimeve.
- 2.5. Vendim i Dekanit për miratimin e grupeve të vlerësimit për transferimin e studimeve (2019, 2020).
- 2.6. Orientimi dhe Këshillimi i studentëve tanë për kalimin në studimet pasuniversitare.
3. Veprimtaritë e nxënësve.
- 3.1. Pjesëmarrja në Panairin e Punës.
- 3.2. Veprimtaritë për vitet akademike 2017-2020.
- 3.3. Dosja: Njihuni me Kolegjin Universitar “LOGOS”.
- 3.4. Klubet studentore dhe veprimtaria e tyre.
- 3.5. Procesi i përpilimit të kalendarit lidhur me aktivitetet e nxënësve 2020-2021.
- 4.1. Mbështetja që Kolegji Universitar LOGOS u jep studentëve nëpërmjet dhënies së bursave.
- 4.2. Programi i bursave.
- 4.3. Kuotat e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS” nga viti 2017-2020: për studentët që i përkasin kategorive të caktuara sociale.
- 4.4. Materiale/broshura informuese të studentëve.
- 4.5. Mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të nxënësit; Kolegji Universitar “LOGOS”.
- 4.6. Mentorim për studentët e Kolegjit Universitar LOGOS.
- 4.7. Propozim për koordinator programi (Shembull Bachelor TLLM 2019, 2020, Master Professional TLLM 2020).
- 4.8. Takimi me studentët për të marrë komente për mësimin në distancë - shembull, Raportimi për takimin me studentët e arsimit parashkollor).
- 4.9. Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek, Vendim Nr. 3, datë 15.11.2020 Për Regjistrimin në Kursin e Vjeshtë 2020.
- 4.10. Shembull i dosjes personale të studentit.
- 4.11. Metodatat e reja të mësimdhënies (Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës).
- 5.1. Analiza e punësimit të studentëve të diplomuar.
- 5.2. Sugjerime nga Kolegji Universitar LOGOS, të dhëna nga studentët të diplomuar në lidhje me programet e studimit të ofruara.
- 5.3. Sugjerime nga punëdhënësit në lidhje me studentët e Kolegjit Universitar LOGOS pjesë e programeve praktike.
- 5.3.1. Informacion statistikor nga “Urdhri i Infermierit” për rezultatet e provimeve të studentëve që ndjekin programin e Teknikave të Avancuara në Laboratorin Mjekësor, 2019-2020, 2020-2021.
6. Këshilli Studentor.
- 6.1. Organizimi i zgjedhjeve për Këshillin Studentor.
- 6.2. Shembull shqyrtimi i çështjeve të ngritura nga Këshilli Studentor.
- 6.3. Financimi i aktiviteteve të propozuara nga Këshilli Studentor.
7. Praktikantët profesionale.
- 7.1. Paketa e Praktikës Profesionale për programet e studimit universitar dhe pasuniversitar.
- 7.2. Formulari i miratimit të praktikës nga Departamenti.
- 7.3. Senati Akademik, udhëzues praktike, laboratorë online.
- 7.4. Formulari i Vlerësimit të Studentëve, TLLM Master 2019 (Model).

- 7.5 Formulari i vlerësimit nga pedagogu kryesor Master 2019 (Model).
- 7.6 Programi i “Praktikës” për Master Profesional TLLM – i detajuar.
- 7.7 Raport për ecurinë e Praktikës së Studentëve.
- 7.8 Kërkesa për praktika drejtuar Laboratorit Mjekësor dhe Lista e studentëve dhe institucionit ku ata kanë kryer praktikën.
- 8. Detyrimet e institucionit ndaj studentit.
- 8.1 Kontrata Studentore 2018 -2019 (shembull programi BSc Informatikë e Aplikuar).
- 8.2 Karta e studentit.
- 8.3 Sigurimi studentor.
- 9. Regjistrat.
- 9.1 Regjistrat e regjistrimit të studentëve.
- 9.2 Korrespondencë me QSHA për pajisjen me NIM.
- 9.3 Regjistri i Studentëve.
- 9.4 Regjistri Elektronik i Studentëve.
- 9.5 Regjistrat e Diplomave të Logos.
- 9.5.1 Regjistri i Diplomave OSHA.
- 9.5.2 Regjistri Elektronik i Diplomave QSHA.
- 9.6 Regjistri i arritjeve (me shkrim).
- 9.6.1 Regjistri i arritjeve (elektronik).
- 10. Format i Provimit Anonim.
- 10.1 Rregullat e Provimit (Shembull Vendimi Nr. 1, datë 19.02.2020 Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës).
- 10.2 Provim Anonim.
- 10.3 Orari i provimeve dhe angazhimi i stafit.
- 10.4 Publikimi i rezultateve të provimit.
- 10.5 Rezultatet e provimeve në sekretariat.
- 10.6 Shembull i provimeve mes semestri (Njohuri historike dhe didaktikë).
- 11. Orari i studentëve Mars 2020.
- 12.1 Procesi i diplomimit të studentëve - Shembull; Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës.
- 12.2 Propozimi i Departamentit për temat e diplomës — Shembull; Teknika të Avancuara në Laboratorin Mjekësor.
- 12.2.1. Lista përfundimtare e temave 2019 për programin e studimit Bachelor në Teknika të Avancuara në Laboratorin Mjekësor.
- 12.3 Diplomë në Master Financë – regjistruar QSHA.
- 12.4 Diploma dhe suplementi i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi.
- 12.5 Numri unik identifikues i Diplomës - Master Profesional.
- 13. Tabela përmbledhëse që tregon numrin e studentëve të regjistruar 2017-2020.
- 13.1 Statistikat për studentët e huaj në Kolegjin Universitar Logos, 2017-2020.
- 13.2 Numri i Studentëve për Programin e Studimit.

### **Shtojca - VIII – Marrëveshjet e bashkëpunimit.**

- 1. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Kolegjit Universitar LOGOS.
- 2. Marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet e Arsimit të Lartë.
- 3. Marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare të Arsimit të Lartë dhe në kuadër të programit Erasmus +.
- 4. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet joarsimore.
- 5. Bashkëpunimi me Institucionet e Arsimit Parauniversitar.
- 6. Korrespondenca e Kolegjit Universitar Logos në kuadër të zgjerimit të rrjetit të bashkëpunësorëve.
- 6.1 Korrespondencë me Universitetin Evropian të Romës.
- 6.2 Korrespondencë me Universitetin e Egjeut.

## 6.3 Korrespondencë me Universitetin e Janinës

### **Shtojca IX Çështje financiare.**

1. Vendim i SA, Nr. datë 13.02.2019, Për miratimin paraprak të Projektbuxhetit të vitit 2019, Kolegji Universitar LOGOS.
  - 1.1 Vendim i Bordit të Administrimit Nr.11, datë 1.4.2019, Miratimi i Projektbuxhetit Kolegji Universitar LOGOS 2019.
- 1 2. Përbërja e Bordit të Administrimit.
2. Sugjerimet e Departamentit për hartimin e Projekt-Buxheteve; Kolegji Universitar LOGOS.
  - 2.1 Udhëzues për hartimin e buxhetit.
3. Raporti i auditimit 2017.
  - 3.1 Raporti i Auditimit 2019.
4. Njoftimi i detyrimeve financiare të prapambetura të vitit 2020.
  - 4.1 Detyrimet tatimore 2021.
  - 4.2 RAPORTI DRT 2020.
5. Njoftimet për detyrimet e bilancit.
6. Ekzekutimi i buxhetit për vitet 2018, 2019, 2020.
  - 6.1 Mbështetje financiare për stafin akademik në lidhje me veprimtaritë shkencore jashtë vendit
  - 6.2 Mbështetje financiare për lëvizjen e studentëve jashtë vendit.
7. Kërkesa e departamentit lidhur me nevojat për realizimin e programit të studimit.
8. Projektbuxheti 2020-2024 i ripunuar.
  - 8.1 Projektbuxheti i Departamentit të Shkencave Mjekësore.

### **Shtojca X – Infrastruktura.**

1. Kontrata e huasë dhe planet e ndërtimit-Kampus 1.
  - 1.1. Kontrata e huasë dhe planet e ndërtimit-Kampus 2.
2. Inspektimi teknik i Kampusit 1.
  - 2.1 Inspektimi teknik - Kampusi 2.
  - 2.2 Licenca e vlerësimit teknik individual/individë.
3. Raporti teknik i datës 19 dhjetor (pas tërmetit).
4. Leje Higjiene-Sanitare 2017, Kampusi 1.
  - 4.1 Raport Higjiene-Sanitar 2013, Kampusi 2.
  - 4.2 Raporti i inspektimit 2019, kampus.
5. Raporti i Infrastrukturës 2020.
  5. Zgjerimi i infrastrukturës.
  5. Vështrim i përgjithshëm i ndërtesave të kampusit (Tabela).
  - 5.3. Infrastruktura e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.
6. Plani i evakuimit për kampusin 1.
  - 6.1 Plani i evakuimit për kampusin 2.
7. Certifikatat e mbrojtjes nga zjarri 2020, Kampusi 1+2.
  - 7.1 Trajnim, Certifikimi për mbrojtjen nga zjarri 2020.
8. Kontrata e Mbrojtjes së Punës.
  - 8.1 Raport Analiza e treguesve fiziko-kimikë.
  - 8.2 Kontratë pune me mjekun që i shërben institucionit.
    - 8.3.1 Back-up i dokumenteve të rëndësishme të ruajtura në Google Drive 1.
    - 8.3.2 Back-up i dokumenteve të rëndësishme të ruajtura në Google Drive 2.
    - 8.3.3 Korrespondenca për procedurat fillestare të ngritjes së sistemit të sigurisë dhe shpërndarjes së dokumentacionit të institucionit..

## **Shtojca XI – Faqja e internetit e Logos, Shërbimet Mbështetëse dhe të tjera.**

1. Faqja e internetit e LOGOS-it.
2. Qendra e Gjuhës Greke pranë Kolegjit Universitar LOGOS.
3. Profili LOGOS në portalin U-ALBANIA.
- 4.1. Fletëpalosje të LOGOS-it në anglisht.
- 4.2. Fletëpalosje të LOGOS-it në shqip.
- 4.3. Fletëpalosje të LOGOS në shqip.
- 5.1. Faqja EduPage.
- 5.2. Office 365.
- 5.3. Manuali i EduPage - Profesorët - Mësime të Redukuara-Online.
- 5.4. Manuali i përdoruesit të Office 365 Teams për Profesorët e Kolegjit Universitar LOGOS.
- 5.5. Njoftim dhe komunikim për trajnime rreth platformave të reja digjitale.
6. Laboratorët e Informatikës dhe Ekonomisë.
- 6.1 Kërkesë për laboratorë shtesë në mbështetje të Departamentit të Teknikave të Avancuara në Laboratorët Mjekësorë.
7. Biblioteka e Kolegjit Universitar LOGOS (Seksioni i përshkrimit).
- 7.1 Llogaria në Questia.
- 7.2 Literatura e siguruar nga biblioteka e Kolegjit Universitar LOGOS.
- 7.3 Karta e Regjistrimit të Bibliotekës së Kolegjit Universitar LOGOS.
- 7.4 Kërkesë për libra nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës.
- 7.5 Kërkesë për literaturë nga Fakulteti Ekonomik.
- 7.6 Plani financiar i propozuar për literaturë për Teknikat në Laboratorët Mjekësorë.
- 7.7 Abonimi i revistës Monitor.
8. Aktivitetet e sallave të konferencave.